

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7640 E hënë 3 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SPARTAK TOPOLLAJ

**L**ista e politikanëve antishqiptarë në Serbinë e këtyre tridhjetë viteve të fundit është tejet e gjatë, ndaj edhe ne e kemi pasur dhe e kemi të lehtë t'i ...

Vijon në faqet 20-21

Aleksandar Vučić, antishqiptari dinak dhe miku serb i Edi Ramës



Reportazhi


Ditës

Nga REZARTA DELISULA

**A**ta jetojnë mes majave të larta, në shkajin më verior të Shqipërisë. Janë shtatlartë e faqekuq, për shkak të ajrit mbushur me oksigjen. Nuk janë të ashpër ...

Vijon në faqet 18-19

Rrugëtim në viset e shqipes...



Flet i vëllai i Fatbardh Licit: Shteti po bashkëpunon me krimin

## Plumba në shtëpinë e Klodiana Lalës dhe vrasja e biznesmenit, Xhafaj mbledhje urgjente

Policia: Dyshime se biznesmeni u vra gabimisht, autori s'ka pasur objektiv Ferracakun

Nga SENAD NIKSHIQI

Pas vrasjes së shtetasit Arjan Ferracaku në Shkodër disa detaje të reja janë zbuluar. Burime të sigurta policore bëjnë me dije se 30-vjeçari Arjan Ferracaku mund të jetë vrarë gabimisht. Sipas burimeve autori ka pasur në ...

Në faqet 6-7

## INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE: SI MUND TA MERRNI SHITESEN MUJORE

# PENSIONISTET, KUSH PERFITON KOMPENSIMIN PREJ 760 LEKE

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të dorëzoni. Kompensimi i energjisë elektrike për fshatin dhe qytetin dhe personat kujdestarë



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

“TE VIHEN PARA LIGJIT”

PD: Rama shpërdoroi për luks 11.3 mld lekë, 188 milionë vetëm për dy limuzina luksoze

Në faqen 3

KRYEMINISTRI NE VLORE

Librat falas për fillloren, Rama: Mos i dëmtoni, në fund të vitit do t'i dorëzoni

Në faqen 2

LIFEPAGES

Rezart Xhani: Zmadhimi

i prostatës, trajtimi me ilaçe e kirurgjikal. Merija: Propolisi ilaç...

Suplement

NE KERMIM TE TJERE

Kapet skafi me 550 kg drogë në Brindisi me vlerë 5 milionë euro, në pranga një shqiptar

Në faqen 8

INTERVISTA | KREU I LZHK; SI I GJYKOJ NDERKOMBETARËT



Shehi: 140 deputetë jemi shumë, duhen reduktuar. “Zgjedhja” me lista të hapura

Në faqet 4-5

Ekskluzive / Dokumenti tepër sekret i sekretarit të parë të Korçës, Enver Halili

## Raporti i Sigurimit: Në 1979-ën në Korçë kishim 45 agjentë

“Mos u merrni me vllahët, boll keni goditur për spiunazh”

Nga DASHNOR KALOÇI

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe



sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohesh; “nën ...

Në faqet 10-11

## QEVERISJA AKUZAT

Kryeministri prezanton rrugën Lin-Pogradec: E gjetëm të braktisur

# Librat falas, Rama: Mos i dëmtoni, në fund të vitit do t'i dorëzoni

"Librat paketë e re nga "Oxfordi", "Cambridge", "Pearson"

Kryeministri Edi Rama takoi dje mësues e prindër në qytetin e Vlorës, ku pati mundësinë që të shpërndajë dhe libra falas për disa prej nxënësve. Përpara datës 17 shtator, kur nis edhe viti i ri shkollor, 125 mijë nxënës të fillores do të marrin librat falas. Kryeministri Rama dhe ministrja Nikolla nga Vlorë gjatë një takimi me prindër dhe mësues u kërkuan dje nxënësve të mos dëmtojnë librat, pasi në fund të vitit duhet t'i dorëzojnë sërish. Në të kundërt sipas vendimit që ka marrë Këshilli i Ministrave familjet duhet të paguajnë tekstat. "Librat do të merren falas e do duhet të kthehen përsëri në fund të vitit. Do duhet të mbahen me kujdes, me dashuri e të kthehen. Nuk është një shpikje e jona. Kemi marrë disa kritika apo qesëndi për këtë, por nuk është një shpikje e jona dhe nuk është vetëm një çështje materiale, por është edhe një mënyrë për të krijuar një raport të posaçëm me librin. Franca nuk është një vend i varfër", deklaroi z.Rama. Tekstat falas janë për nxënësit nga klasa e parë deri në të katërt, por qeveria pretendon që vitin tjetër të përfshijë edhe klasat e pesta, duke zgjeruar gamën e përfituesve dhe duke ndihmuar familjet në vështirësi. "Prindërit e fëmijëve të klasës së parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe vitin e ardhshëm edhe të pestë, nuk do të shpenzojnë më për të blerë tekstat, por ato para do t'i kenë në arkën e buxhetit të familjes për shpenzime të tjera", theksoi kryeministri Rama. Kurse ministrja e arsimit Lindita Nikolla u shpreh: "Mjaftoi vetëm dëgjimi i mësuesve që ato të refuzonin 600 tekste nga alterteksi". Vitet e fundit, prindër mësues dhe njohës të çështjeve të arsimit ngritën debatin publik, shqetësim për cilësinë e teksteve mësimore dhe përmbajtjen e tyre. Përmes një grupi pune Ministria e Arsimit hoqi nga përdorimi tekstat me përmbajtje të papërshtatshëm dhe me gabime. Ndërsa kryeministri Rama garanoi se pake-



Kryeministri Edi Rama duke shpërndarë libra falas për nxënësit e qytetit të Vlorës

ta e re e librave vjen si një model dhe përkthim nga "Oxfordi", "Cambridge" dhe "Pearson". "Na vjen shumë mirë që ia dolëm në këtë proces, e që tani kemi mundësinë që edhe një tjetër kontribut të prindërve për familjen e fëmijët ta zëvendësojmë me një kontribut të shtetit. Hap pas hapi, përpjekjet, sakrificat dhe dhimbjet që shoqërojnë reformat po kthehen dhe masat e vështira po sjellin një forcë për

shtetin. Duke u ardhur në ndihmë fëmijëve, u bëjmë të mundur familjeve që t'i përdorin për diçka tjetër shpenzimet për libra", tha Kryeministri. Z.Rama tha, gjithashtu, se falë reformave e kontributeve të të gjithëve rriten mundësitë e shtetit për të investuar më shumë fonde në favor të familjeve e të fëmijëve. Kryeministri shtoi se librat e rinj, falas për rreth 190 mijë fëmijë, janë tani më paketë e re

nga 'Oxfordi', 'Cambridge', 'Pearson', që kanë zëvendësuar kështu malet me gropa të teksteve që për shumë vite lmeritën mësuesit, prindërit e nxënësit. Po dje kryeministri Rama prezantoi një projekt të qeverisë siç është aksi rrugor Lin-Pogradec. Në postimin e tij kryeministri shkruan se e ka gjetur këtë rrugë të nisur kurturë dhe të braktisur. "MIRËMËNGJES dhe me pamjet e një tjetër rrugë kombëtare me shumë rëndësi edhe për turizmin, e cila më në fund doli në dritë (e gjetëm dhe këtë rrugë të nisur kurturë, pa projekt e pa fonde, të braktisur pas daulleve të inaugurimit, si një korridor nën qiell të hapur mes ndërtimeve pa leje e pallateve të ndërhuara mbi gjoll), ju uroj një të diel të bukur. Aksi rrugor Lin-Pogradec është 16.5 km dhe ka standardin europian C1. Shumë shpejt do të përfundojë edhe kontrata tjetër për veprën e gjysmë-tunelit panoramik prej 1 km, që do të mundësojë më në fund hyrjen e denjë në qytetin e bukur turistik", tha z.Rama.

### Deputeti Boçi denoncon skandalin në arsim

## PD: Ministria krim ekonomik me mësuesit, nuk iu paguan siguracionet

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi përmes dokumenteve denoncoi dje një skandal, pasi sipas tij mësuesve nuk u paguhen siguracionet. Me anë të një postimi në 'Facebook', Boçi shkruan se Ministria, nëpërmjet DAR-(je)ve, u mohon mësuesve, pa dënimin e tyre, pagesat për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore. Sipas tij ky fakt është një skandal i madh, pasi mësuesit punojnë në të zezë. "Sa mësuesve sot, pa dënimin e tyre, nuk i janë paguar sigurimet shoqërore e shëndetësore? Ministria ndërkohë në vend që të bëjë deklaratat që nuk ia di as vetë kuptimin, duhet të shkojë me këmbët e



veta drejt organeve ligjzbatuese, për të mbajtur përgjegjësi për krimin financiar të radhës, ndaj mësuesve", shkruan z.Boçi. Sipas tij "Ky fakt është më tronditës dhe skandal i madh. Ministria, nëpërmjet DAR-(je)ve, u mohon mësuesve, pa dënimin e

tyre, pagesat për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore. Megjithatë janë definitivë, ministria i konsideron sikur ata punojnë në të zezë, sikur të ishin emigrantë në vendin e tyre. E bën këtë tinëzish, në shkelje të plotë të ligjit, duke konsumuar kështu një krim financiar. N.q.s. do ta bënte këtë një biznes qoftë dhe i vogël e priste menjëherë dëra e burgut. Mësuesi është tronditur teksa ka parë në dokumentin e kërkuar prej tij, nga Drejtoria e Tatimeve, se sigurimet e tij mungonin në disa muaj. Ai privohet në këtë mënyrë në përfitim të plotë pensionit dhe shërbimeve shëndetësore".



Mbledhje qeverie

### DEKLARATA

"Librat do të merren falas e do duhet të kthehen përsëri në fund të vitit. Do duhet të mbahen me kujdes, me dashuri e të kthehen. Nuk është një shpikje e jona. Kemi marrë disa kritika apo qesëndi për këtë, por nuk është një shpikje e jona dhe nuk është vetëm një çështje materiale, por është edhe një mënyrë për të krijuar një raport të posaçëm me librin. Franca nuk është një vend i varfër", tha z.Rama.

### Shehu: Rama dhe administrata e tij keqpërdorin fondet publike

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu, në një postim në "Facebook", shkruan se Rama ka realizuar vetëm në 3D premtimin për ujë në Libohovë. Sipas tij kryeministri dhe kryetarja e Bashkisë premtuan se do të kishte ujë, që tre vite më parë, por gjendja është në përkeqësim të vazhdueshëm. "Kryeministri i realizon premtimet vetëm në 3D, kjo vlen edhe për ujë e Bashkisë së Libohovës. Tre vjet më parë, gjatë fushatës për zgjedhjet lokale, kryeministri dhe kryetarja aktuale e Bashkisë së Libohovës (shto edhe ministrën e Kulturës), premtuan për të gjithë atë bashki 24 orë ujë të pijshëm. Mbas tre vitesh gjendja është tragjike, në përkeqësim të vazhdueshëm. Asnjë investim real në ujësjellësin 50-veçar të atyshëm, në depot e ujë e në pjesët e rrjetit. Në fakt, edhe mirëmbajtja, pastrimi i depove, kontrolli i cilësisë së ujit etj., janë në "pikë të hallit!", shprehet z.Shehu. Ai akuzon se: "Fryrja artificiale e tejskajshme e administratës në atë bashki, keqpërdorimet, paafësitia, kanë bërë që edhe punonjësit e ujësjellësit të mos paguhen rregullisht, apo kanë krijuar probleme të mëdha me pagesat e energjisë, qoftë dhe për sistemet e pompimit të ujit, të domosdoshme kë to për pjesët e sipërme. Këto dhe le jimi i shpërdoruesve rilindas apo korruptiv të ujit, ka bërë që koha e furnizimit me ujë në ato pjesë të Libohovës të mos arrijë 60 minuta në 24 orë dhe të Nepravishtës të jetë në 15-30 minuta".





Pelinku: Kryeministri do të vihet para ligjit bashkë me firmëtarët e tenderëve korruptivë

# PD: Rama shpërdoroi për luks 11.3 miliardë lekë

## "188 mln lekë për dy limuzina luksoze"

Valentina Madani

Demokratët akuzuan dje kryeministrin Edi Rama se për luksin qeveritar ka shpërdoruar 11.3 miliardë lekë ku 188 mln lekë janë përdorur vetëm për dy limuzina luksoze. PD siguroi kryeministrin se do të vihet para ligjit bashkë me firmëtarët e tenderëve korruptivë. Përmes një deklaratë për mediat, drejtuesja e Departamentit të Antikorrupsionit në Partinë Demokratike, Lealba Pelinku, ka thënë se brenda 8 muajsh, qeveria e Ramës ka shpërdoruar për luks 11.3 miliardë lekë, aq sa është fondi për ndihmën ekonomike. Pelinku u shpreh se AKU dhe AKT kanë përveçësuar 188 milionë lekë nga buxheti i shtetit vetëm për dy limuzina luksoze. "Qeveria e Ramës, në 8 muajshpërdoroi për luks 11.3 miliardë lekë, aq sa është fondi për ndihmën ekonomike", deklaroi drejtuesja e Departamentit të Antikorrupsionit në Partinë Demokratike, Lealba Pelinku. Në një dalje për mediat Pelinku tha se vetëm për vitin 2018 qeveria e tepsisë Rama, ka shpenzuar miliardë lekë për blerje apo qira makinash për zyrtarë e qeveritarë. Më tej ajo u shpreh se me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike, do të vihen përpara ligjit të gjitha ata që kanë firmosur tenderë korruptivë, nga Rama e deri tek punonjësit e thjeshtë. "Ndërsa Shqipëria kryeson turpshëm listën e vendeve të varfëra, qeveria Rama për pesë vite ka vazhduar praktikën e shtimit të luksit për interesa personale, praktikën e shpërdorimit të parasë publike për luksin personal. Rama urdhëroi shpërdorimin e miliardave lekëve të marrë borxh nga FMN, duke i kthyer në bojë për fasada, duke rritur borxhin publik në kufijtë më të lartë në histori", tha Pelinku. Por sipas saj grabitja nga korrupsioni nuk ndalet me miliardat në të ashtuquajturën "rindiljen urbane". "Sa më shumë shfletohet fletoret e buletinet e tenderëve publikë, aq më shumë merrroshesh nga skandalin në të cilin është përfshirë kjo qeveri dhe kjo



Drejtuesja e Departamentit të Antikorrupsionit në Partinë Demokratike, Lealba Pelinku

mazhorancë. Sipas shifrave zyrtare të publikuara nga vetë qeveria, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka shpenzuar nga buxheti i tij, 88 milionë lekë për një limuzinë 'Sedan', ndërkohë që Agjencia Kombëtare e Turizmit, një tjetër qendër korrupsioni e Edi Ramës, ka shpenzuar 100 milionë lekë për 1 automjet të vetëm", u shpreh zyrtarja e PD-së. Ajo akuzoi se këto dy institucione janë vetëm disa nga lista e gjatë e atyre segmenteve të qeverisë që abuzojnë, keqpërdorin paratë e shqiptarëve, ndërkohë që 38% e shqiptarëve kanë shpenzuar më pak për ushqim të tyre e të fëmijëve të tyre. Kjo sipas saj është qeveria që në vetëm 8 muaj të këtij viti ka shpenzuar 11.3 miliardë lekë, aq sa vlera e ndihmës ekonomike në buxhet, vetëm për serviset e luksit të automjeteve të qeveritarëve. "Në vetëm 8 muaj 20 miliardë lekë i janë hequr shqiptarëve për të blerë a marrë me qira automjete me specifitime që sheikët dhe bosët e mafias ia lejojnë vetes. Kjo sepse zyrtarët e Ramës së charterave, duhet të udhëtojnë si turistë klasi nga një qytet në tjetrin, duke dhënë spektaklet e radhës me një popul që nuk ushqen dot fëmijët e tij dhe që i largon ata nga bankat e shkollës. 113 milionë lekë automjet 'Sedan' blen Kuvendi i Shqipërisë pa iu dridhur dora, ndërkohë që nuk ka para për të persekutuarit e pronarët e nëpërkëmbur. Kjo është keqqeverisja që Edi Rama dhe banda e tij në pushtet i ofron sot shqiptarëve. Ndaj Partia Demokratike, fton qytetarët, gjithë ata që ende kanë shpresë se ky vend meri-

ton më të mirën, t'i thonë stop qeverisë që vjedh ndihmën ekonomike dhe e kthen në luks për qeveritarët", deklaroi zj. Pelingu. Ajo garantoj se Partia Demokratike, me ardhjen e saj në pushtet do të hartojë një ligjislacion që jo vetëm i jep fund kësaj gra-

**AKUZA**

"Qeveria e Ramës, në 8 muajshpërdoroi për luks 11.3 miliardë lekë, aq sa është fondi për ndihmën ekonomike. Në vetëm 8 muaj 20 miliardë lekë i janë hequr shqiptarëve për të blerë a marrë me qira automjete me specifitime që sheikët dhe bosët e mafias ia lejojnë vetes", deklaroi drejtuesja e Departamentit të Antikorrupsionit në PD Lealba Pelinku.

bitje, por që do të vendosë para ligjit qdo zyrtar, nga Edi Rama deri tek më i thjeshti firmëtar tenderësh, PPP-sh apo koncesioni korruptiv në këtë vend.

**ABUZIMI**

"113 milionë lekë automjet 'Sedan' blen Kuvendi i Shqipërisë pa iu dridhur dora, ndërkohë që nuk ka para për të persekutuarit e pronarët e nëpërkëmbur. Kjo është keqqeverisja që Edi Rama dhe banda e tij në pushtet i ofron sot shqiptarëve", - shprehet PD.

### Ish-ministrit: Dy njerëzit që shqiptarët nuk do i harrojnë

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani nuk e kursyer ironinë me dy politikanët shqiptarë, kryeministrin e Shqipërisë dhe presidentit të Kosovës. Me një postim të shkurtër, ai shprehet se dy janë njerëzit që shqiptarët nuk do t'i harrojnë kollaj. 'Hashimi dhe Hashishi', shkruhet në foton e bërë publike nga Manjani. 'Po jetojmë kohë të mëdha! Shqiptarët nuk do t'i harrojnë në shekuj të dy këto leader të gjatë...', shkruan ish-ministri i Drejtësisë Ylli Manjani.



**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbartimore L.D.C**

-Aparamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leke.

Data e shpalljes 01.08.2018  
Data e zhvillimit 05.09.2018 deri ne oren 16:00  
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbartimore L.D.C**

-"Aparament", me sip. 69.2 m2, Nr pasurie 10/158+2-1, Z. K 8631, vol. 9, fq 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1 Lezhe. Prona eshte e regjistruar prane Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Lutizim Kros Beqiri . Çmimi i ri per shitje eshte 2.170.000 Leke.  
Data e shpalljes 06.08.2018  
Data e zhvillimit 11.09.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**Njoftim për shitje me ankand**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorëzueshëm K. S. të ndodhura në fshatin Fanishore. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:  
"Pasuria 'Are' me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869, me cmin prej 80.000 lekë  
"Pasuria 'Are' nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmin prej 80.000 lekë  
"Pasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadestrale 2869 me cmin në masën 400.665 lekë  
Ankandi është progresivë e do të zhvillohet dt 13.09.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1, Kati 2, zyra 5. Kont. tel. 672082543, e-mailit iilr\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

# STRATEGJIA E OPOZITËS

## INTERVISTA

Kreu i LZHK: Nëse ka ndërkombëtarë që duan ta bëjnë zhele Shqipërinë, dikush duhet të paguajë

# Dash Shehi: 140 deputetë jemi shumë, duhen reduktuar

“Ligji për magistratët është ligji i “shelgut””

Valentina Madani

Dashamir Shehi mbart një eksperiencë të gjatë politike ndaj akuzon me bindje të plotë se qeveria aktuale është më hajdutja që kanë pasur ndonjëherë shqiptarët. Por përmes "Gazeta Shqiptare", kreu i LZHK-së shigjeton edhe ndërkombëtarët që kanë punuar për të mbajtur në pushtet Edi Ramën. Z.Shehi thotë se "nëse ka ndërkombëtarë që duan ta bëjnë zhele Shqipërinë, atëherë dikush duhet të paguajë". Dashamir Shehi flet për debatin e ashpër politik, aksionin opozitar, reformën e re elektorale dhe zgjedhjet e ardhshme lokale. Ai apelon për zgjerimin e aleancës së djathtë me parti dhe individë që mbartin vlera ndërsa ka dhe një përgjigje nëse do të pranjojë kandidimin e tij përballë Erion Veliaj në Tiranë. Z.Shehi beson se opozita e bashkuar ka të gjitha shanset që të fitojë jo vetëm kryeqytetin, por gjithë Shqipërinë përballë një mazhorance sipas tij që ka rrjepur xhepat e shqiptarëve.

**Z.Shehi, a besoni se pushimet e verës do zbusin disi tonet mes mazhorancës dhe opozitës, apo do kemi rritje të temperaturash në Kuvend, i cili nis sot punimet?**

Ne na është thënë se do shkojmë në luftë (qesh) politike kuptohet. Megjithatë një gjë duhet të dini që të gjitha partitë e opozitës janë në unison dhe të gatshëm për të sfiduar qeverinë, pavarësisht se edhe opozita ka hallet e vet, por jam i bindur se jemi alternativë qeverisëse. Ne si opozitë jemi në një rrugë



Dashamir Shehi

ngjitetje, pasi rruga opozitare është gjithë e më e vështirë, është "malore". Por besoj se do të ketë dalje dhe dritë jeshile për opozitën. Besoj se po pipjet momenti, shqiptarët po binden se në dorë të kujt qeverie kanë hyrë dhe po binden edhe ndërkombëtarët që shpesh herë "padashje" kanë mbështetur vetëm qeverinë. Kështu që besoj se ka ardhur koha që opozita të korrë rezultatet pozitive. Pra, rruga jonë është "malore".

**Çfarë halesh ka opozita...?**

Hall më i madh i opozitës është gjithë shqiptarëve është kjo qeveri që kemi sot. Është qeveria më hajdute që mund të kemi pasur ndonjëherë. Qeveria "Rama" u mbledh paratë fukarenjve dhe u jepën 10 zenginëve. Do t'i kisha mbyllur të gjitha koncesionet. Këto koncesione e kanë futur Shqipërinë në borxhe për 10 vite. Kot kemi ankuar për Rrugën e Kombit, shikoni shifrat për rrugët që po ndërtohen, për stadiumin dhe Teatrin, ilacet dhe spitalet. Nuk ka asnjë garë të hapur. Në sebeb të atyre të mëparshme janë 100-fishuar vjedhjet. Bëjmë të gjithë si Shekspirë e Hamletë. S'ka asnjë budalla që nuk nënkupton që Rama ka 20 vjet që ia ka vënë syrin asaj cope tokë te Teatri. Shikoni shëmtinë e

stadiumit, është një markatë që ka edhe një fushë futboll. Kjo është vjedhje e pastër. Ky vend s'ka para për ujësjellës dhe rubinete, kërkon para nga ndërkombëtarët, por për palatë 200 milionë eurosh i kemi paratë. Por ne na intereson se si në vjeshtë do të reagojnë qytetarët e Tiranës. Frikë duhet të ketë Rama. Ai flinte poshtë urave të Parisit. Duhet t'u dalim për zot interesave të Shqipërisë.

**...Qoftë edhe përmes zgjedhjeve të parakohshme?**

Në një situatë të jashtëzakonshme, kërkohen zgjidhje të jashtëzakonshme. Vëndin e ka shkatërruar ky kryeministër që vetëm vjedh për veten dhe njerëzit e tij ndërkohë që shqiptarët nuk sigurojnë dot bukën e gojës. Por unë kam optimizmin se shqiptarëve u ka ardhur në majë të hundëve me këtë qeveri grabitqare dhe do reagojnë në mënyrë pozitive. Nuk them se këtë gjë nga krahu jonë është mrekulli, por krahu tjetër është i baltosur nga krimi dhe korrupsioni. Është emergjencë largimi i Edi Ramës nga qeveria. Mundësisht ai duhet shporur që sot nga pushteti. Opozita e bashkuar do të dijë t'i japë atij përgjigje që meriton.

**...Edhe me mosbindje civile?**

Opozita do të përdorë çdo

### MANDATET

"Unë për vete do të zgjidhja një sistem, i cili është mazhoritar, i kombinuar me proporcional. Do të reduktoja numrin e deputetëve, jemi shumë tashmë, 140. I rikthejmë të drejtën shqiptarëve për të votuar jo vetëm partinë, por edhe individin".

mjet demokrat brenda dhe jashtë parlamentit për largimin një orë e më përpara të Kryeministrit Edi Rama dhe shpursë së tij që po e rrjepin Shqipërinë dhe shqiptarët. Aksioni nis që sot në parlament dhe do të vazhdojë intensivisht derisa Edi Rama të mos jetë më në krye të qeverisë dhe kjo do të ndodhë shumë shpejt sepse shqiptarët do të reagojnë pasi u ka ardhur në majë të hundës qeverisja e këlyshëve të komunistëve. Janë 2 deri 3 miliardë lekë të shpërdoruara nga kjo qeveri. Boll më. Shqiptarët nuk do e durojnë rrënimin e tyre për shkak të keq-qeverisjes së Edi Ramës.

**A është e gatshme opozita të vijë në pushtet nëse do të rrezoni Edi Ramën, a ka kapacitetet e duhura opozita që të qeverisë së shpejti shqiptarët?**

Kur kishte rilindja kapacitete për të qeverisur me hajdutë, me bijtë e ish-byrositëve që nuk kishin lexuar asgjë përveç librave të Stalinit, apo me homoseksualë, si nuk paska opozita kapacitete. E djathta është gati të vijë në pushtet, sepse kapacitete të shumta që garantojnë qeverisje të drejtë për qytetarët shqiptarë.



**Cila është rruga më e lehtë që e çon opozitën drejt pushtetit?**

Opozita duhet të zgjerohet. Aleanca duhet të shtohet dhe nuk kam parasysh këtu vetëm subjektet politike, por edhe individë që mund të mos jenë dakord me partitë, por janë vlerë dhe i duhen të djathtës shqiptare.

**Kë kemi parasysh kur flisni për individë...?**

Nuk është çështja të flasim me emra, por duhen afruar të gjithë ata që janë kundër kësaj qeverisje.

**Përshih edhe Bamir Topin dhe partinë e tij?**

Sigurisht. Ne po bashkëpunojmë me një parti që ka qenë pjesë e bashkëqeverisjes së Ramës dhe jo me parti të spektrit të djathtë. Opozitës i duhen të gjitha ata që janë kundër Edi Ramës dhe shpursës së tij.

**Gjithsesi beteja politike nis sot në Kuvend. Mazhoranca akuzon opozitën për vonesat në zbatimin e reformës në drejtësi tekta i kërkon votat për magistratët e rinj. A duhet t'i bashkojë PD votat me PS-në në këtë rast, duke marrë parasysh edhe apelin e ndërkombëtarëve për zgjidhjen e ngërcit?**

Për mendimin tim, jo. Opozita bën aq sa mundet. Nëse ka edhe ndërkombëtarë

që duan ta bëjnë zhele këtë Shqipëri, atëherë dikush duhet të paguajë. Nuk është faji i opozitës për ngërcin sot në drejtësi, por duke munguar një drejtësi e pavarur; e përcaktuar në mënyrë definitive me institucionet e veta, pushteti i vetëm absolut në Shqipëri mbetet pushteti i PS-së dhe i Edi Ramës. Duke i përcaktuar gjyqtarët dhe prokurorët në mënyrë të drejtpërdrejtë, sigurisht do të mihnen në shumë vështirësi të kryejnë drejtësi. Këta pushtetarët socialistë nuk tremben fare për korrupsionin që ka sot qeveria e tyre, kur qindra milionë euro nga ata konsiderohen të parëndësishme. Sot vetëm iniciatorët janë mbi 150 milionë euro abuzime, të mos harrojmë pastaj për kokainën, kanabisin, për policët që arratisen. Asnjëherë shteti shqiptar nuk ka qenë në gjunjë para Krimit, siç ndodh sot. Ndaj PS-ja bën zhurmë që të fshihet pengesat që i vë ajo drejtësisë.

**Pse opozita e refuzon ndryshimin e ligjit?**

Ne gjykojmë se ligji për magistratët është ligji i "shelgut" siç më pëlqen ta thërras apo etiketoj unë. Ishte ligji i "plepit" ai, ndërsa ky është ligji i "shelgut". E dyta, domethënë nuk ka gënjeshtrë më të madhe që kjo qeveri e servir në këtë mënyrë ligjin për të

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

##### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1. LLOJIT 'APARTAMENT'; VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE B350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PELLUMB META DHE Z.NJ. RITA META  
ÇMIMI 4.118.696 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 13.09.2018  
CEL. 0684026666 ; 0693262866.

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

##### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA E LLOJIT 'PYLL + KULLOTË', ME SIPERFAQE 190.000 M2, ZONA KADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NË PRONËSI TË Z. FATION UKA.  
ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.09.2018.  
CEL. 0684026666 ; 0693262866.



Përmbarusi Gjyqesor Privat Çezar Beja

Përmbarusi Gjyqesor Privat Çezar Beja me adresë Lagja Nr 2, Rruga "A. Goga", Qendra "Eden" Kt 3, Durrës, Tel 0674053771, email cezarbeja@hotmail.com  
Shpall ankandin e dytë për pasuritë e paluajtshme të debitorit Hysni Vah Gjergji, Suzana Rrahman Gjergji, Rajl Hysni Gjergji.  
1.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 94, ZK 3137, Vol 4, Fq 78, Sip 2950m2, Adresa Rade, Njesia

Administrative Manëz, Bashkia Durrës

Çmimi ne ankandin e dyte eshte 2534.400 leke

Z.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137,

Vol 5, Fq 82, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njesia

Administrative Manëz, Bashkia Durrës

Çmimi ne ankandin e dyte eshte 4316.400 leke

Ankandi do te zhvillohet ne zyren e permbarusit gjyqesor privat Çezar Beja

ne daten 20.09.2018 duke u mbyllur ne oren 16.00





"Qeveria 'Rama' ua solli në majë të hundës shqiptarëve, opozita gati të vijë në pushtet"

# Kandidimi përballë Veliajt, Shehi: Brenda së djathtës 100 emra

"Zgjedhorja, ndryshim sistemi dhe lista të hapura"



Dashamir Shehi

**ZGJEDHJET**  
"Në një situatë të jashtëzakonshme, kërkohen zgjidhje të jashtëzakonshme. Vendin e ka shkatërruar kryeministri që vetëm vjedh për veten dhe njerëzit e tij ndërkohë që shqiptarët nuk sigurojnë dot bukën e gojës", - theksoi kreu i LZHK-së

sistemi i drejtësisë, është t'i konsiderosh fare, madje fare "budallenj". Dhe ky është një turp i madh. Nga ana tjetër, më lejoni të shtoj se magistratët në rastin më të mirë do të shërbenin vetëm nëse do të përzgjidheshin normalisht dhe kishte një marrëveshje, si të thuash për të ripërtëritje sistemin në një kohë afatgjatë. Por jo për sot. Magistratura është një shkollë që zgjat 3 vjet në rastin më të mirë. D.m.th do të mbarojnë 15 të parët pas 3 vjetësh, ndërsa ata që do të zëvendësojnë 300 gjyqtarët dhe prokurorët do duhen edhe shumë vite.

**Të ndalemi pak te reforma zgjedhore. Flitet arrijten e një dakordësie PD-PS për çështjen e reformës së re elektorale. A besoni se po bëhen pazare në kurriz të partive të vogla?**

Uroj mos të jetë siç thoni ju. Kryetari Basha e mohoi të ketë dakordësi me PS-në dhe unë besoj z.Basha në këtë rast. Ne kemi pasur një premtim solemn, politik nga zoti Basha, që këto janë zgjedhjet e fundit që bëj unë si kryetar i PD-së. Zgjedhjet e ardhshme, deputetët do t'i zgjedhin qytetarët, votuesit. Deri tani dy partitë e mëdha që kanë edhe drejtimin e Komisionit të Reformës Zgjedhore nuk kanë bërë asgjë dhe shpresojmë që debati të rihapet në vjeshtë. Mirëpo, duhet të dini edhe një gjë që si PD, ashtu edhe PS ndryshimet nuk i bëjnë për ne por mendojnë për veten e tyre. Pra, di të them se Partia Demokratike vetëm humbje do të ketë nëse mendon vetëm për vete, ashtu si Partia Socialiste. Megjithatë, shpresoj se kërkesat tona do të merren parasysh. Nga ana tjetër, mendoj se kjo nuk është punë parti të mëdha, apo parti të vogla por duhet t'i shërbejmë qytetarëve shqiptarë. Si përfundim ne do ta mbështesim reformën zgjedhore, duke shpresuar se do të bëhet një sistem i gjatë pranuar për të gjithë.

**Në të kundërt...?**  
Ndryshe ne do të rishikojmë pozicionet tona. Partia që unë drejtoj, madje ne si aleatë i mbështesim ndryshimet për reformën zgjedhore. Unë jam autori që kam gati 10 vjet që luftoj për reformën zgjedhore. Kështu që nëse nuk bëhen ndryshimet për reformën zgjedhore, kjo re-

**elektoral kërkoni?**

Unë për vete do të zgjidhja një sistem, i cili është mazhoritar, i kombinuar me proporcional. Do të reduktoja numrin e deputetëve, jemi shumë tashmë, 140. I rikthejmë të drejtën shqiptarëve për të votuar jo vetëm partinë, por edhe individin. Gjë që ia kemi mohuar fare. Unë do të vija një sistem mazhoritar i korrektuar me proporcional në raporte dy me një që praktikisht, korrektimi shkon pothuajse deri në fundit. Është e domosdoshme të ndryshohet sistemi, që mund të bëjë përzgjedhje përtej flamurit politik, ose të bëhen lista të hapura, ose një pjesë e zonave të bëhen mazhoritarë, sepse deri më sot shqiptarët votojnë listën që u ofron kryetari. Ky do ishte revolucion i madh, do kthenite demokracinë dhe do krijonte piramidën e vlerave, një elitë politike, sepse vota e popullit do tregonte sa vlen

ky. Ndërsa sot elitën e partive e bëjnë kryetarët e partive dhe fatkeqësisht janë bërë një grup servilësh që produktivitetin e tyre e tregojnë politikë. Duhet edhe depolitizimi i komisioneve zgjedhore. Kam njëzet vjet që e mbështes këtë ide. Sot me këtë trysni që ka politika, që është futur në xhepat e shqiptarëve, e vetmja mënyrë është që të votojmë elektronikisht, më pas edhe me depolitizim dhe komisione partiake, të rrinë si vëzhgues nga jashtë.

**A kanë nisur ende bisedimet brenda opozitës për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme lokale?**

Jo, ende nuk ka bisedime, por besoj nga fundi i javës do të ketë një takim të PD-së me aleatët dhe të shohim se çfarë do të diskutohet.

**Është përmendur edhe emri juaj si një ndër kandidatët e fortë të opozitës që mund të jetë përballë Erjon Veliajt në Tiranë. Nëse ju kërkohet, do të kandidoni?**

Si unë ka 100 të tjerë. Por unë kam hyrë si dikushi në politikë dhe qëndroj si dikushi në politikë. Opozita ka shumë kapacitete. Sa i takon kandidimet tim me kësmet, pasi është një çështje që ne si opozitë do ta zgjidhim në momentin e duhur. Sepse për momentin kemi tema më të mëdha, sidomos sa i takon raportit me qeverinë qendrore, kemi nevojë për ligj zgjedhor, kemi nevojë për kushte të reja për të hyrë në zgjedhje. Pra, tema se kush është kandidati i opozitës për Tiranën, është dytësore, është e negociueshme dhe rinegociueshme. Kemi kohë deri atëherë. Por nëse opozita është solide dhe e bashkuar të jeni të bindur se do të fitojë jo vetëm Tiranën, por mbarë Shqipërinë.

**ALEANCA**

"Ne po bashkëpunojmë me një parti që ka qenë pjesë e bashkëqeverisjes së Ramës dhe jo më me parti të spektrit të djathtë. Opozitës i duhen të gjitha ata që janë kundër Edi Ramës dhe shpurrës së tij", -deklaroi kreu i LZHK-së.



**Bushati takon Palmer: Vlerësohet zbatimi i reformës në drejtësi**

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati takon zv/ asistent sekretarin e shtetit Matthew Palmer. Gjatë punimeve të Forumit të Dubrovnikut me temë: "Forcimi i elasticitetit - Mesdheu, Evropa dhe Ballkani Zhëvendimor", Bushati zhvilloi një takim me Palmer. Gjatë këtij takimi, Palmer vlerësoi ritmin e reformave të brendshme duke u ndaluar veçanërisht te zbatimi i reformës në drejtësi. Ai, gjithashtu, vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm konstruktiv të Shqipërisë në rajon.

mashtuar shqiptarët. Kjo është e papranueshme. Pra, që të bëj një shpjegim të thjeshtë magistratët në rastin më të mirë mbarojnë pas tre vjetësh. Ndërkohë që nga ana tjetër, që të bëhen të gjithë magistratët, në mënyrë që të zëvendësohen ata që janë hequr, duhet minimalisht 6 deri në 7 vjet. Kështu që e gjitha kjo është një teatër i kotë, i luajtur nga mazhoranca. Magistratët nuk zgjidhin as punën e Gjykatës Kushtetuese, as punën e Gjykatës së Lartë. Pasi minimalisht një magistrat, sipas ligjit që kemi ne, i bie pas nja 10 apo 15 vjetëve, sepse magistratët është ai që sapo ka mbaruar shkollën. Domethënë sikur çështja e magistratëve shërben për të zgjidhur problematikën imediate që ka sistemi i drejtësisë, që janë Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, plotësimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por që, për fat të keq, magistratët nuk hyjnë fare në këtë mes. Magistratët janë studentët që do të bëhen gjykatës dhe prokurorë për të ardhmen, teksa më i afërti do të bëhet pas 4 vjetëve, ndërsa më i largëti do të bëhet pas 7 ose 8 vjetëve, por sa kohë që do të vijojë vetingu. Kështu që të tallesh me shqiptarët dhe t'iu thuash se çështja e magistraturës zgjidh çështjen e krizës në të cilën ndodhet sot

## VRASJA NE SHKODER HETIMET

Mbi 15 të shoqëruar në polici për vrasjen e 30-vjeçarit, mes të cilëve dëshmitarë

# Policia: Dyshohet se biznesmeni Shkodran u vra gabimisht

*Autori nuk ka pasur në objektiv Arjan Ferracakun*

Senad Nikshiqi

SHKODER

Pas vrasjes së shtetasit Arjan Ferracaku në Shkodër disa detaje të reja janë zbuluar. Burime të sigurta policore bëjnë me dije se 30-vjeçari Arjan Ferracaku mund të jetë vrarë gabimisht. Sipas burimeve autori ka pasur në objektiv një person tjetër për ta vrarë, por ka gabuar në shënjestër duke lënë të vrarë Ferracakun. Gjithashtu, zbardhet dinamika e ngjarjes, lidhur me vrasjen e Arjan Ferracaku në zonë e 'Livadeve' në Shkodër, mesditën e së shtunës.

### DINAMIKA E NGJARJES

Autori i këtij krimi ka qëndruar për disa kohë i fshehur pas shkurreve në pjesën periferike të 'Livadeve' ndërsa e ka ditur se objektivi i tij dhe personat e tjerë do të vinin aty. Sapo kanë mbërritur, autori ka qëlluar nga një largësi prej afro 70-100 metër duke tentuar që të vrasë objektivin e tij. Në fakt, ka gabuar në shënjestër dhe gabimisht është plagosur shtetasi Arjan Ferracaku. Personat e tjerë që e shoqëronin viktimën janë larguar me shpejtësi për t'i shpëtuar plumbave pasi ata nuk kanë ditur se nga vinin të shtënë për shkak se autori ka qëndruar i fshehur, ndërkohë nuk dihej se sa persona po qëllonin në drejtim të tyre. Arjan Ferracaku dhe shtetasit e tjerë që ishin me të ndodheshin mbi kuaj duke bërë hipizëm dhe parapërgatitje për kampionatin me kuaj që ishte parashikuar me 15 shtator në plazhin e Veli-pojës. Pasi autori ka lënë të plagosur shtetasin Arjan Ferracaku ka dalë nga vendi ku fshihej dhe e ka qëlluar sërish për të humbur çdo gjurmë në këtë krim të



Viktima Arjan Ferracaku

ndodhur edhe pse objektivi kishte një person tjetër. Forcat e policisë kanë bërë shoqërimin e të paktën 15 personave në policinë vendore të Shkodrës, mes të cilëve janë dëshmitarët që kanë dëgjuar krimin në vendngjarje, por edhe persona të tjerë që mund të kenë dijeni apo familjarë të viktimës. Dëshmitarët sipas burimeve policore janë shprehur gjyqësorë e policisë gjyqësore se ata vetëm kanë dëgjuar krimin dhe se nuk kanë arritur që ta shohin autorin për shkak se ai ishte fshehur ndërsa janë larguar me shpejtësi për t'i shpëtuar plumbave. Në këtë mënyrë dëshmitarët nuk kanë

dhënë asnjë detaj që mund ta ndihmojë policinë në identifikimin e autorit të mundshëm. Nga ana tjetër policia e Shkodrës ka pyetur edhe familjet e viktimës, por ata kanë mohuar se mund të kenë pasur probleme apo se vetë 30 vjeçari ka pasur ndonjë problem. Policia vijon hetimin për këtë ngjarje e cila dyshohet se mund të ketë lidhje edhe me ngjarjet e tjera kriminale të ndodhura në Shkodër tre muajt e fundit. Po ashtu policia vijon edhe kontrollin në qytet për të rënë në gjurmët e autorit të mundshëm. Deri më tani ende nuk është identifikuar. Po ashtu për mënyrën se si

është kryer kjo vrasje dhe kujdesin për të mos lënë asnjë gjurmë efektive do ta kenë të vështirë për të zbuluar autorin dhe për të zbardhur vrasjen e ndodhur. Kujtojmë se në vendin ku ndodhi vrasja përveç efektivëve të komisarariatit shkuan edhe Forcat e Ndërhryes së Shpejtë dhe struktura të tjera policore. Efektivët të gjithë së bashku kanë nisur një punë intensive për të arritur në identifikimin e autorit dhe më pas gjetjen dhe kapjen e tij. Jo vetëm në afërsi të vendit të ngjarjes por edhe kudo tjetër përreth policia po bën kontrollin të imtësishme për të arritur në gjetjen e ndonjë gjurme të autorit të kësaj vrasjeje. Nga ana tjetër janë ngritur disa postblloqe në aksin Shkodër-Hani Hotit por edhe pjesë të tjera në qytetin e Shkodrës dhe zonën në afërsi të 'Livade' ku ndodhi vrasja. Deri më tani policia ende nuk ka rënë

### EKZEKUTIMI

Autori ka qëlluar nga një largësi prej afro 70-100 metër duke tentuar që të vrasë objektivin e tij. Në fakt, ka gabuar në shënjestër dhe gabimisht është plagosur shtetasi Arjan Ferracaku. Personat e tjerë që e shoqëronin viktimën janë larguar me shpejtësi për t'i shpëtuar plumbave pasi ata nuk kanë ditur se nga vinin të shtënë për shkak se autori ka qëndruar i fshehur, ndërkohë nuk dihej se sa persona po qëllonin në drejtim të tyre.



### DËSHMITARËT

Dëshmitarët sipas burimeve policore janë shprehur për oficerët e policisë gjyqësore se ata vetëm kanë dëgjuar krimin dhe se nuk kanë arritur që ta shohin autorin për shkak se ai ishte fshehur ndërsa janë larguar me shpejtësi për t'i shpëtuar plumbave. Në këtë mënyrë dëshmitarët nuk kanë dhënë asnjë detaj që mund ta ndihmojë policinë në identifikimin e autorit të mundshëm.

## Vrasja e biznesmenit, akuza e Berishës: Rama mbulon krimin me shpërndarje abetaresh

Kryeministri Edi Rama u shfaq ditën e djeshme në qytetin e Vlorës duke shpërndarë tekste shkollore për nxënësit. Këtë deputeti i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e ka konsideruar "show abuziv me fëmijët". Në një status në 'Facebook', ish-kreu i qeverisë akuzon Ramën se "bandat e tij fshihen pas vrasjes së biznesmenit Arjan Ferracaku në Shkodër". "Arjanin e vranë bandat e Noriges ndërsa Kallam Dëshaku përpiqet të mbulojë krimin e shëmtuar duke shpërndarë abetare në një show abuziv me fëmijë të klasës së parë! Sb," shkruan Berisha në 'Facebook'.



në gjurmët e autorit të vrasjes dhe bashkëpunëtorëve të tij në këtë krim të ndodhur.  
**VRASJET NË**

### SHKODËR

Në Shkodër në vetëm dy muaj e gjysmë janë vrarë 6 persona ndërsa dy të tjerë rezultojnë të zh-

**SHPELLIJE ANKANDI**  
Datë 06.09.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall anandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Luan Zef Palli dhe dorëzantes Loretta Pjetër Palli.  
"Apartment" me sipërfaqe 88.9 m2, nr.i pasurisë 4/162+1-12, zona kadastrale 8631, vol. 6, faqe 20, adresa: Rruga "Gurra", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë.  
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 2 419 984 (dy milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.





← dukur. Fillimisht është vrasja e shtetasit Mehdi Kavaja, i cili u qëllua me plumb pas koke në servisën e tij të makinave, pas tij u qëlluan çifti Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci që u vranë në sytë e fëmijës 2 vjeçar për të ardhur më pas tek vrasja e Fatbardh Licit, rasti i parafundit është i shtetasit Prendush Fusha që u qëllua me thikë në zemër nga Alfred Pllumbaj për të vijuar me dy persona që prej 10 ditësh rezultojnë të zhdukur, Gëzim Hysaj nga Postriba dhe nipi i tij Agron Mollaj nga Dobraqi dhe në fund është vrasja e një dite më parë e Arian Ferracaku. Nga këto 6 ngjarje ka arritur që të largohet prej autorit.

**VIKTIMA**

Arian Ferracaku kishte në pronësi disa biznese në plazhin e Velipojës dhe në Shkodër bashkë me familjen e tij. Prej shumë vitesh kanë ushtruar këtë aktivitet me bizneset e tyre. Sipas burimeve Arian Ferracaku nuk ishte një person problematik në qytetin e Shkodrës në të kaluarën e tij. Në vendin e ngjarjes ka rritur që të kalonte 30-vjeçari ka marrë dy plumba, por edhe pse i plagosur ka arritur që të largohet drejt banesës të viktimës. Të gjitha forcat e policisë po punojnë për zbardhjen e plotë të kësaj vrasjeje dhe kapjen e autorit.



**TIRANE** - Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka thirrur një mbledhje urgjente me drejtuesit e policive të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Vlorës e Shkodrës.

**Sulmi ndaj biznesmenit e gazetares, Xhafaj mbledh me urgjencë drejtuesit e policisë "Hetoni me efikasitet, dua rezultate konkrete"**

Burime për BalkanWeb bëjnë me dije, se mbledhja u thirr pas ngjarjes së Tiranës (plumbave ndaj shtëpisë së gazetares Klodiana Lala) dhe asaj të Shkodrës (ku u vra një biznesmen).

Në këtë mbledhje mësohet se Xhafaj u ka bërë thirrje drejtuesve të policisë të ndërmar-

rin masa të ashpra reaguese. Thelbi i takimit ishte apeli për angazhim maksimal në funksion të luftës ndaj krimit, duke u referuar te ngjarjet e fundit. Të njëjtat burime, bëjnë me dije për BalkanWeb se ministri kërkoi me forcë rezultate konkrete nga të gjitha strukturat, hetim të

shpejtë dhe te gjithanshëm si dhe efikasitet në punën hetimore, përmes bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese. Xhafaj kërkoi nga Drejtori i Përgjithshëm, Ardi Veliu, largimin nga Drejtoritë Vendore apo Policia Kriminale te efektivëve te paafte dhe për të cilët ka indicie për im-

**plikim**

Ministri inkurajoi për veprime hetimore policore të thelluara dhe bashkëpunim intensiv me prokurorinë, si edhe denoncim të rasteve nëse do të rezultojë që prokurorë të caktuar zvarrisin e pengojnë ecurinë e hetimeve, apo hezitojnë të lëshojnë urdhra ndalimi për persona të implikuar. Nga drejtuesit e policisë është kërkuar me shumë mbështetje nga prokuroria, nga strukturat vendore të SHISH, si dhe nga institucionet e tjera si Tatime, Dogana, Burgjet etj.

"Në Shkodër së fundmi janë 6 të vranë dhe 2 të humbur, shumica e ngjarjeve pa autor"

Senad Nikshiqi

**SHKODER**

**N**jë muaj e gjysmë pas vrasjes së shtetasit Fatbardh Lici në Shkodër, vëllai i tij Mustaf Lici njëkohësisht anëtar në këshillin bashkiak të Shkodrës, përmes një deklarate për media bën të ditur se policia në Shkodër po bashkëpunon me bandat e qytetit. Një ditë më parë policia e Shkodrës pas vrasjes së shtetasit Arjan Ferracaku në zonën e 'Livadeve' ka shprehur për të marrë në pyetje edhe djalin 16-vjeçar të Mustaf Licit. Ky i fundit shprehet se për çdo ngjarje që ndodh në Shkodër policia shkon në banesën e familjes Lici. "Sot ky qytet po vuan një diktaturë të madhe që nuk është parë as në 1946. Sot në këtë qytet janë 6 të vranë dhe 2 të humbur. Pjesa më e madhe e ngjarjeve janë pa autor. Vrasjet këtu në Shkodër janë bërë në bashkëpunim të bandave me policinë. Sa të jetë kjo polici nuk do të ketë as edhe një zbardhje të ngjarjeve, sepse kjo polici është në mbështetje të bandave të qytetit të Shkodrës. Këto banda kanë marrë forcë nga policia. I shpreh ngushëllimet të gjithë familjarëve me sinqeritetin më të madh. Rasti i fundit i vrasjes të Arjan Ferracaku, policia ka marrë dy fëmijë njëri 15 vjeç dhe tjetri 16 vjeç. 16 vjeç është djali im. E marrin këtu në shtëpi dhe policia e mban 4 orë. Shtëpia jonë është bërë poligon qitjesh nga regjimi diktatorial i kësaj qeverisjeje", u shpreh Mustaf Lici. Vëllai i Fatbardh Licit ka një thirrje të gjerë dhe bën të ditur se shteti dhe bandat po krijojnë trysni tek qytetarët e Shkodrës ndërsa familje e tij qëndron e ngujuar nga frika e shtetit dhe jo e bandave. "Ne jemi në ngujim. Mua më kanë vranë vëllain dhe, sic e shihni ju vetë, kemi çuar llamarinat në lartësi. Jemi të ngujuar dhe qëndrojmë në shtëpi, sepse nuk jemi në gjendje të lëvizim pranun e derës. Ky shtet po krijon trysni ndaj familjes tonë dhe disa familje të tjera, por posaçërisht

**Vrasja e Fatbardh Licit, flet vëllai: Shteti bashkëpunon me bandat Mustafa Lici: Pas vrasjes së Ferracakut policia shoqëroi djalin tim 16-vjeçar**



ndaj familjes tonë. Kjo është një trysni që ne nuk e kemi patur as në 1946, as në vitet e diktaturës. Të gjitha shkeljet njerëzore që i bëjnë këto njerëz i bëjnë nën pagesat e parave, kanë vënë aq shumë lekë sa blejnë çdo lloj shefit, çdo lloj policit", -thotë vëllai i Fatbardh Licit. Anëtar i këshillit bashkiak të Shkodrës ndjen keqardhje ndërsa shprehet se policia i ka shpallur luftë familjes së tij për të mbështetur bandat. Mustaf Lici thekson se do kërkojë drejtësi deri në Strasburg për atë që po ndodh me familjen e tij dhe qytetarët e Shkodrës. "Unë dhe familja ime deri dje kemi ushtruar aktivitetet tona shumë të lira ndërsa kemi tre javë që nga vrasja e vëllait tim dhe ne jemi të ngujuar, jo se na kanë ngujuar bandat, por na ka ngujuar shteti. Çdo orë shteti silltet me furgona policie përreth shtëpisë, me nga dy-tre furgonë. Çdo incident që kryhet në Shkodër, çdo

**EKZEKUTIMI I FERRACAKUT**

"Rasti i fundit i vrasjes të Arjan Ferracaku, policia ka marrë dy fëmijë njëri 15 vjeç dhe tjetri 16 vjeç. 16 vjeç është djali im. E marrin këtu në shtëpi dhe policia e mban 4 orë. Shtëpia jonë është bërë poligon qitjesh nga regjimi diktatorial i kësaj qeverisjeje", -u shpreh Mustaf Lici.

mirë se as shteti dhe as bandat nuk e trembin familjen Lici që e përdhunojnë çdo javë e çdo ditë, vijnë e na rrethojnë kot", shprehet Mustafa Lici.

**VRASJA E FATBARDH LICIT**

Plot 15 plumba janë zbratur mbi 53-vjeçarin Fatbardh Lici, pak metra larg banesës së tij, në një lokal në lagjen "Guerile" më 10 gusht. Fatbardh Lici, ishte ulur në të njëjtin lokal ku ulej çdo ditë për të pirë kafe. Autori me sa duket i dinte mirë lëvizjet e tij. Është afruar me një automjet tip "Benz" në lagje, ka zbritur prej saj dhe e ka qëlluar me disa plumba. Ai ka vepruar me gjakftohtësi dhe është larguar sërisht me automjetin tip "Benz" të cilin blutë e Shkodrës e gjetën në flakë pak minuta pas ngjarjes në zonën e Dobraqit. U bë me dije, gjithashtu, se policia e ka pak të vështirë identifikimin e autorit, pasi në rrugicën ku ndodhi krimi nuk ka pasur kamera sigurie. Lici ishte babai i tre fëmijëve, dy djemve dhe një vajze. Policia po heton në pistën e gjakmarrjes, pasi 53-vjeçari ishte i përfshirë në vrasjen e Astrit Kurmemajt 7 vite më parë. 53-vjeçari është vëllai i Mustaf Licit, anëtar i këshillit bashkiak të Shkodrës dhe kryetar i partisë "Mendimi i Djathtë Liberal", si dhe kunati i biznesmenit Lulzim Kulla, i cili aktualisht ndodhet në burg.



**FAMILJA LICIT**

"Ne jemi në ngujim. Mua më kanë vranë vëllain dhe, sic e shihni ju vetë, kemi çuar llamarinat në lartësi. Jemi të ngujuar dhe qëndrojmë në shtëpi sepse nuk jemi në gjendje të lëvizim pranun e derës. Ky shtet po krijon trysni ndaj familjes tonë dhe disa familjeve të tjera por posaçërisht ndaj familjes tonë. Kjo është një trysni që ne nuk e kemi pasur as në 1946, as në vitet e diktaturës. Të gjitha shkeljet njerëzore që i bëjnë këto njerëz i bëjnë nën pagesat e parave, kanë vënë aq shumë lekë sa blejnë çdo lloj shefit, çdo lloj policit", -thotë vëllai i Fatbardh Licit.

Ngujimi

plumb që nxirret në Shkodër edhe pa vrasje menjëherë rrethohet familja ime nga policia dhe marrin në shtëpi nga 3-4 vetë, ju marrin gjurmët e gishtave dhe i lëshojnë pas 4 orësh. Herë marrin 3-4 vetë, herë 1-2 sa të gjejnë në shtëpi. Ne do

bëjmë punën tonë nëpërmjet mediave por do t'i drejtohem edhe Strasburgut për këto që ndodhin në familjen tonë. Do ketë drejtësi edhe më lart, drejtësia është edhe në Strasburg edhe atje do të drejtohem, por ta dinë

Policia: Viojnë hetimet për të zbuluar persona të tjerë të implikuar

# Kapet skafi me 550 kg drogë në Brindisi, në pranga një shqiptar

Marijuana e sekuestruar kapte vlerën e 5 mln eurove

ITALI

Policia italiane në bashkëpunim me policinë shqiptare kanë finalizuar një operacion antidrogë në Brindisi. Në kuadër të këtij operacioni është ndaluar një skaf dhe janë sekuestruar 67 pako me 550 kg marijuanë që sipas mediave italiane dyshohet se vinte nga Shqipëria. Në reagimin e Policisë së Shtetit thuhet se në kuadër të këtij operacioni janë arrestuar dy trafikantët, një shtetas shqiptar me inicialet V.B 29 vjeç dhe një shtetas italian me inicialet E.F 33 vjeç. Sipas mediave vendase, nëse do të shitej në tregun me pakicë, marijuana do kapte vlerën prej rreth 5 milionë eurove. Mësohet se skafi ishte 6.5 metra dhe është sinjalizuar nga patrullimi i agjencisë Frontex, në zonën e ujërave ndërkombëtare dhe po shkonte drejt brigjeve italiane. Policia e ka arritur skafin dhe i ka bërë thirrje të ndalojë. Sipas policisë trafikantët tentuan të arratiseshin në det, dhe rritën shpejtësinë e mjetit, por pas ndjekjes së shkurtër, ata u arrestuan. Ndërkohë policia shqiptare dhe italiane bëjnë me dije se hetimet po vijojnë në të dy krahet e kufirit për të zbuluar persona të tjerë të implikuar. Mediat italiane shkruajnë se marijuana kapte vlerën e 5 mln eurove në treg.

## NJOFTIMI I POLICISË SHQIPTARE

Policia e Shtetit dhe forcat policore italiane në veçanti Guardia di Finanza e Pulias kane finalizuar një tjetër operacion duke goditur tentativën për trafik narkotikësh drejt Italisë. Autoritetet arrestuan 2 trafikantët, një shtetas italian me inicialet E.F dhe shtetas shqiptar me inicialet V.B. Në Brindisi u kap dhe sekuestrua skafi me të cilin u tentua të trafikohet droga, si dhe 550 kg marijuanë. Aktivizuar edhe në këtë rast bashkëpunimi tashmë i konsoliduar operativ dhe in-



formativ me autoritetet e policisë shqiptare nëpërmjet nuklit të kufirit detar të Guardia di Finanza dhe zyrës së ndërlidhjes së poli-

cisë shqiptare në Itali. Hetimet po vijojnë në të dy krahet e kufirit për të zbuluar persona të tjerë të implikuar.



## Përfshihet nga zjarri magazina e kafes në Fier, pronari: Dëmi shkon në 500 mijë euro

**Fier.** Një zjarr i madh ka përfshirë ditën e djeshme një magazinë të pjekjes dhe ambalazhimit të kafes në qytetin e Fierit. Ngjarja ka ndodhur në lagjen '16 Prill' dhe sipas raportimeve është djegur totalisht stoku i kafes që ndodhej në magazinë. Magazina e kompanisë "Oscar & Geno" është djegur plotësisht, duke shkrumbuar rreth 70 tonë kafe, e cila ndodhej e paketuar në ambientet e brendshme gati për t'u tregtuar. Dëmi sipas pronarit përlogarit deri në 500 mijë euro, por do pritet për vlerësimin e saktë të ekspertëve. Mendohet që shkaku i zjarrit të ketë qenë një shkëndijë elektrike e njëres prej pajisjeve. Dyshohet se ka qenë një pirun, i cili po karikonte bateritë shkaktar për nxitjen e zjarrit. Ndërkohë që të gjithë pajisjet janë shkrumbuar. Në magazinë ka pasur edhe bombola gaz, që fatmirësisht nuk kanë shpërthyer pas ndërhyrjes së zjarrfikësve. Mbërritja e shërbimit zjarrfikës bëri të mundur nxjerrjen e gjashtë bombolave të gazit nga ambientet e magazinës, të cilat përdorshin për pjekjen e kafesë. "Në datën 02.09.2018, rreth orës 15:30, në lagjen "16 Prill", në magazinën me kafe në pronësi të shtetasit H.O ka rënë zjarr. Në vendngjarje u dërguan shërbimet e policisë dhe shërbimi zjarrfikës, të cilat bënë të mundur fikjen e zjarrit. Nga hetimet paraprake dyshohet se zjarri ka rënë për shkak të një shkëndije elektrike në magazinë", thuhet në njoftimin e policisë. Grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të kësaj ngjarje.

## REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (Consulting Company)

ALBANIA  
CITIZEN – CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT  
Loan Agreement  
Project ID No. 8521

Assignment Title: The Preparation of Detailed Design and Supervision for Integrated Service Delivery Center in Kombinat Area, Tirane

Posted: Sept. 01, 2018  
Ref. No. AL-8521-CS/CQ/2.05.08

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" (ISDA), entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and ICT.

Project Implementation aims the refurbishment and reconstruction of the selected premise, which is expected to improve the quality of services for citizens by being closer to the public with the offered services.

The scope of this assignments consists in preparation of the design and environmental checklist of the following activities:

- Task 1: Preparation of the Designs for ISC in Kombinat Area, Tirane
- Task 2: Preparation of Bidding Documents and Cost Estimates of the envisaged Works.
- Task 3: Supervision of works

### COMPANY QUALIFICATIONS

The interested Consultants have to comply with the following minimum qualification requirements:

- The Consultant and its staff must be licensed on the specific categories stated in accordance with Albanian Law. (In design, implementation, supervision of works and environmental studies)
- The tasks shall be performed by Consultant with proven relevant technical experience.
- The consultant must have at least 5 (five) years in design and supervision of the similar projects.
- The consultant must have at least two similar contract including the design and the supervision of works within 5 last years.
- The consultant must have ISO certificate, ISO 9001; 2008, ISO 14001: 2004, ISO 18001:2007

The consultant (its staff) should be licensed in design, implementation and supervision works. Licensed in carrying out environmental studies.

### Key personnel/staff PROJECT MANAGER

#### Senior Architect / Designer

Licensed architect, with more than 12 years of experience who has a design or technical focus and is responsible for significant parts of the project and worked in at least in 2 similar projects

#### Architect / Structural Engineer

Licensed architect with 8–10 years of experience who shall be responsible for significant aspects of projects.

**Civil Engineer (s)** consultants with at least 10 years of general experience and worked in at least 2 similar projects

The civil engineer(s) shall focus on design work and on the physical aspects of the design.

#### Mechanical Engineer graduate degree in field related with mechanical installations

- At least 5 years of general experience at the position of mechanical Engineer of design and/or supervision teams

#### Electrical Engineer

- electrical Engineer with graduate degree in field related with electrical installations
- At least 5 years of general experience at the position of electrical Engineer of design and/or supervision teams

#### Hydrotechnical Engineer

- Hydrotechnical Engineer with graduate degree in field related with hydrotechnical installations
- At least 5 years of general experience at the position of hydrotechnical engineer of design and/or supervision teams

#### Quantity Surveyor

- Quantity Surveyor Engineer, or technician able to check and measure the work quantities
- At least 5 years of general experience at the position of quantity surveyor of design and/or supervision teams

#### Environmental Specialist

- Environmental Specialist with graduate degree in environment
- Certificate from Ministry of Environment
- At least 5 years of experience in environmental issues

#### Fire protection Specialist

- Fire protection Specialist with graduate degree
- Certificate from Ministry of Interior Affairs in the field of fire protection
- At least 5 years of experience in fire protection issues

The Project Management Unit now invite eligible "Consultants" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014)* ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualification (CQ) Method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The REOI is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): [www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al).

Expressions of interest (Company Profile, CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by **September 17, 2018, at 12.00 local time**

### ADISA

(Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)  
Blvd: Zhan d'Ark,

Ish shtëpia e oficerave, Kati VI-te  
Tirana, Albania

E-mail: [roland.jarashi@adisa.gov.al](mailto:roland.jarashi@adisa.gov.al);  
[informacion@adisa.gov.al](mailto:informacion@adisa.gov.al) and  
[ccsdprojectalbania@gmail.com](mailto:ccsdprojectalbania@gmail.com)



## PENSIONET E PLEQËRISË KOMPENSIMET MUJORE

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë të moshuarit. Kompensimi i energjisë elektrike

Voltiza Duro

Të gjithë individët që marrin pension pleqërie, invaliditeti apo familjare, në masën e plotë apo edhe të pjesshme mund të përfitojnë një kompensim të të ardhurave mujore deri në 760 lekë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha kriteret që duhet të përmbushin të moshuarit për të marrë këtë pagesë kompensuese si në qytet edhe në fshat. Kështu kanë të drejtë të përfitojnë deri në 760 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo për llogaritjet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 760 lekë dhe ajo që del pjesëtohet me pensionin bazë. Gjithashtu, këtë kompensim mujor e marrin edhe individët që përfitojnë pensione të plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare si dhe ata që marrin pensione të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, në zbatim të VKM nr. 401. Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

**KOMPENSIMI PËR PENSIONET E FSHATIT**

Në buxhetin e shtetit parashikohet kompensimi deri në 690 lekë edhe për të ardhurat mujore të pensioneve të fshatit për të gjithë ata që marrin pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar fshati. Përfitues nga ky kompensim mund të jenë të gjithë ata që marrin pensione të pleqërisë të plota dhe të pjesshme, ata që përfitojnë pension invaliditeti të plotë, të reduktuar apo të pjesshëm si dhe ata që marrin pension familjar të plotë ose të pjesshëm. "Përfitohet: a) Deri në 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritjet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 690 lekë dhe prodhimi që del, pjesëtohet me pensionin bazë të miratuar; b) 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare; c) Deri në 690 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 690 lekë, dhe nga kjo shumë zbrisim pensionin e caktuar brenda këtij kufiri; d) Kjo e ardhur është pjesë

# Pensionistët në fshat dhe qytet, kush përfiton kompensimin prej 760 lekësh

ISSH: Si mund të merrni shtesën prej 190-500 lekë në muaj

përbërëse e pensionit dhe përfitohet së bashku me pensionin." bën me dije ISSH.

**KOMPENSIMI DERI NË 500 LEKË**

Në bazë të ligjit "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve"; këtë lloj kompensimi deri në 500 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pleqërisë, të plotë, të pjesshëm, të reduktuar dhe pensionet familjare të plota e të pjesshme të qytetit. "Masa e përfitimit: 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë; 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë; Deri në 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, e cila llogaritjet si diferencë ndërmjet kufirit të mësipërm me pensionin e caktuar brenda këtij kufiri; Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.", thekson Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

**KOMPENSIMI DERI NË 200 LEKË**

Këtë lloj kompensimi mbi të ardhurat mujore të pensioneve të qytetit në masën deri në 200 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit. Gjithashtu, këtë përfitim e marrin të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit; si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritjet të gjitha kompensimet. Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

**KOMPENSIMI DERI NË 190 LEKË**

Kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të qytetit deri në masën prej 190 lekësh e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit; të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe



familjare të qytetit; si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritjet të gjitha kompensimet.

**KOMPENSIMI PËR PERSONAT NË NGARKIM TË PENSIONISTËVE**

Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se mund të përfitohet edhe një tjetër lloj kompensimi për personat në ngarkim që ka përfituesi i pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe familjar. Këtë kompensim e përfitojnë të gjithë pensionistët që marrin pension, që kanë anëtarë të familjes në ngarkim dhe që janë me banim të përhershëm në qytet;

kur kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën e lartë; si dhe kur kanë persona të tjerë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune. Ndërkaq masa prej 414 lekësh në muaj jepet për çdo person të familjes në ngarkim në rastet kur fëmijët janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën; si dhe kur nipat, mbesat, kur nuk i kanë prindërit, bashkëjetojnë me pensionistin dhe janë nën moshën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën. Ndërkohë pagesa në masën 207 lekë në muaj, jepet kur një nga prindërit është në marrëdhënie pune, ose në pension. ISSH thekson se ky kompensim nuk përfitohet nga pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtaria ekonomike si të punësuar, punëdhënës, të vetëpunë-

suar, ose kanë tokë në pronësi. Për të përfituar nga kjo masë pagese, të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar si fotokopje e letërnjoftimit elektronik; certifikatë familjare; vërtetim nga shkolla; vërtetim nga zyra e tatimeve, taksave dhe nga bashkitë dhe komunat, për mospatje të aktivitetit; vërtetim nga zyra e punës, si punëkërkuar, për personat që janë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune; si dhe një deklaratë personale.

**KOMPENSIM PREJ 648 LEKËSH**

Nga kompensimi prej 648 lekësh në muaj për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 kwh në muaj, mund të përfitojnë 2 kategori. Respektivisht mund të marrin këtë kompensim kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat si dhe kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Dokumentacioni që nevojitet për të fituar të drejtën e përfitimit përfshin: deklaratën personale; fotokopjen e Letërnjoftimit; fotokopjen e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit; fotokopjen e Librezës së energjisë, që vërtetohet në sek ka detyrimet e paguara; si dhe një certifikatë familjare.

### LLOGARITJA E MASËS

Kështu kanë të drejtë të përfitojnë deri në 760 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo për llogaritjet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 760 lekë dhe ajo që del pjesëtohet me pensionin bazë.

### KOMPENSIMI PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË NGA RRRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË

#### Kush e përfiton:

► Kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

► Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

#### Dokumentacioni që kërkohet:

► Deklaratë personale, që ndodhet, pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore;

► Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit;

► Certifikatë familjare;

► Për fëmijët mbi moshën 18 deri në 25 vjeç, vërtetim që vazhdojnë shkollën.

#### Masa e përfitimit:

► 640 lekë në muaj. Ky shpërblim tërhiqet në postën paguese së bashku me pensionin.

**KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE NË MASËN DERI NË 500 LEKË**

#### Masa e përfitimit:

► 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë; b) 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë;

► Deri në 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, e cila llogaritjet si diferencë ndërmjet kufirit të mësipërm me pensionin e caktuar brenda këtij kufiri;

► Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

## SPECIALE

## DËNIMI I KADRI HAZBIUT, FEÇOR SHEHUT...

Ekskluzive / Dokumenti tepër sekret i sekretarit të parë të Korçës, Enver Halili, për Komitetin Qendror

# Raporti i Sigurimit: "Në 1979-ën në Korçë kishim 45 agjentë të zbulimeve të huaja"

*"Oficerët e drejtimit me porosi të Feçorit kanë thënë: Mos u merrni me vllahët, boll keni goditur për spiunazh".*

Nga DASHNOR KALOÇI

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohesh; "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablonë sinoptike për poliagjentin Mehmet Shehu"? Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesë-marrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur lloj-lloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spiunime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim dhe kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu, familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, ushtarakë, funksionarë të lartë, etj. etj. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe

Ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tri dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të ministrit të Brendshëm), ku dhe ndaj tij, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rrethuar përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto mbledhje, "Gazeta Shqiptare" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerra nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangel Çerrava etj., etj., informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollë-sira gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raporteve, në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raporte kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së Korpuseve ushtarake, që ishin edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në dy numrat e kaluar publikuam raport-informacionin e ish-anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, Spiro Koleka, dërguar Komitetit Qendror, lidhur me aktivin



Kadri Hazbiu në gjyq

e partisë të rrethit të Pogradecit, ku ai ka marrë pjesë si i deleguar, më 25 shtator të vitit 1982. Për të vazhduar nga ky numër e në vijim, (në tre shkrime radhazi) me raport-informacionin "Tepër sekret" të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Korçës, Enver Halili, dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së (personalisht Enver Hoxhës) lidhur me punën dhe veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Korçës si dhe "impulsimin" e Mehmet Shehut, Kadri Hazbiu, Feçor Sheut etj., me punonjësit të Sigurimit dhe persona të tjerë në atë rreth dhe më gjerë.

(vijon nga numri i kaluar)

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE Tepër sekret  
KOMITETI I PARTISE RRETHIT  
Korçë Korçë, më 28.10.1982

INFORMACIO  
N

Për  
DISA PROBLEME QE DUALEEN NGA DISKUTIMI I KONKULZIONEVE TE

BYROSE POLITIKE DHE TE PLENUMIT TE 5-TE TE KQ TE PARTISE  
NE ORGANIZATAT BAZE TE PARTISE TE DEGES SE PUNEVE TE BRENDESHME DHE TE PROKURORI-GJYKATES

Më 23-26 tetor 1982 në të gjitha organizatat bazë të Partisë e në Komitetin e Partisë në Degën e Punëve të Brendshme dhe në organizatën bazë të Prokurori-Gjykatës, u bë diskutimi për problemet dhe detyrat që dalin nga konkluzionet e Byrosë Politike dhe të Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror të Partisë.

Në vijim të solidarizimit me vendimet e Plenumit të 4-të të Komitetit Qendror, të

gjithë komunistët u solidarizuan plotësisht me konkluzionet e Byrosë Politike e të plenumit të 5-të të Komitetit Qendror dhe me vendimet përkatëse që u muarën në këtë plenium. Të gjithë komunistët dënuan njëzëri dhe me urrejtje veprimtarinë armiqësore të armiqëve Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu, Mihallaq Ziqishti, Feçor Shehu e bashkëpunëtorëve të tyre, miratuan njëzëri vendimet përkatëse dhe shprehën dashurinë e besnikërinë e patundur për partinë dhe shokun Enver Hoxha. Në të njëjtën kohë në frymën e kritikës dhe të autokritikës, ata analizuan punën dhe veprimtarinë e tyre në sektorët ku mbulojnë organizatat dhe ngritën problem, të cilat po i themi siç i shtruan vetë ata dhe që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Degës, Prokurori-Gjykatës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Nga ky diskutim doli faktet dhe argumenta që thellojnë njohjen dhe veprimtarinë armiqësore në këto organe.

I. NE DEGEN E PUNEVE TE BRENDESHME

Të gjithë komunistët e konsideruan plotësisht të drejtë konkluzionin e Komitetit Qendror të Partisë se të gjitha komplotet armiqësore



Enver Hoxha, Kadri Hazbiu 1966

janë zbuluar nga Partia dhe jo nga organet e Sigurimit të Shtetit, se në krye të këtyre organeve kanë qenë agjentë të zbulimeve kapitaliste-revizioniste, të cilët me qëllim kanë shtrembëruar punën e Sigurimit dhe kanë kamuflluar veprimtarinë e tyre armiqësore. Në të njëjtën kohë bënë autokritikë duke nxjerrë në pah edhe përgjegjësinë e tyre se nuk kanë ndihmuar Partinë me të dhëna të konstatuara për veprimtarinë e këtyre armiqëve, duke pasur mungesë vigjilence, duke mos i vlerësuar me sy politik orientimet e dhëna nga këta armiq në kundërshtim me orientimet e vendimet e Partisë, kjo edhe për mungesë të kurajos revolucionare për të thënë në kohën e duhur shkeljet e konstatuara nga këta armiq.

KU KA NDIKUAR VEPRIMTARIA ARMIQESORE NE DEGEN E PUNEVE TE BRENDESHME?

1. Shkeljet në zbatimin e vijës e orientimeve të Partisë e lufta e organit për zbulimin e veprimtarisë armiqësore. Veprimtaria e armiqëve që kanë qenë në drejtim të Ministrisë së Brendshme ka ndikuar edhe në punën dhe veprimtarinë e Degës e veçanërisht në sektorin e Sigurimit dhe të Hetuesisë që kanë çuar në disa raste në shkeljen e vijës dhe orientimeve të Partisë.



Kadri Hazbiu me punonjes të sigurimit






manipulimet e tyre miratornin propozime të tilla. Kjo bëhej edhe me fushata, veçanërisht kur shikohej që Dega nuk kishte realizime me goditje, nxitës kryesor për këtë kanë qenë Kadri Hazbiu, Feçor Shehu, Elham Gjika dhe Kadri Gojashi. Po ashtu në rastet e ngjarjeve të rëndësishme bëheshin me goditje duke arrestuar shumë persona.

Të arrestuarit për hedhjen e parrullave në vitin 1975 u çuan në Pogradec dhe u udhëhoq puna dhe hetimi nga Rexhep Kolli dhe ish-zv/drejtori i Sigurimit, Lirim Pellumbi. Mendimi im është që ky proces të ristudiohet.

Sipas orientimeve të dhëna nga Feçor Shehu nga ana e Degës u muarr si objekt i rëndësishë së veçantë Komiteti Ekzekutiv i K.P të rrethit. Eshte bërë praktikë pune që çështjet e rëndësishme që ndiqeshin për krime kundër shtetit të centralizoheshin në Ministri, kur ishte fjala për spiunazh. Disa nga të arrestuarit në Degë, kur jepnin të dhëna në hetim për veprimtari agjenturore të mprehtë, menjëherë merreshin nga Ministria për vazhdimin e hetimeve me pretextin se në qendër ka kuadrot të "kualifikuar", "ka kushte të mira", etj etj. Mendimi është që kjo bëhej me qëllim që të mbulohej ose të kufizohej veprimtaria agjenturore për ato raste që ata kanë interes.

Këto veprime flasin për atë që në disa raste edhe në Degë i janë nënshtruar orientimeve të armiqësorë kundërshtim me vijën e Partisë. Në një analizë të bërë në Sigurim për qytetin e Korçës, Feçor Shehu hodhi orientimin armiqësor në kohën që dëgjoji shiftrën e problemeve që ndiqeshin për spiunazh e ku përqindjen më të madhe e zinin ato për agjentë të zbulimeve të huaja, ai tha: ".....Ku vini ju, çfarë kujtoni, mos na mbytnë spiunët", që edhe kjo ndikoi që në qoftë se në vitin 1978 kishte 45 përpunime për agjentë të zbulimeve të huaja, më 1979 u ul në 40, më 1980, në 28 dhe në 1981 në 28.

Njëkohësisht ai dhe shokët e tij ndikonin nëpërmjet kuadrove që vinin nga qendra për t'i hequr problemet nga ndjekja dhe për të ulur numrin e tyre, duke ndikuar në mënyrë të tërthortë ose nëpërmjet miratimit të veprimeve të tilla. Nga Ministria, oficerët e



duke shfrytëzuar këtë në orientonin që gjithë kohën dhe vëmendjen, punëtori operativ ta harxhonte vetëm në këtë fushë, si rrjedhim edhe në linim detyrat e tjera të rëndësishme funksionale.

Kritika u bë në për sektorin e Hetuesisë për nevojën e thellimit më mirë në procesin e kapjen e fijeve në dalin gjatë hetimit. Për të gjitha sa u thanë më sipër shokët komunistë bënë autokritikë dhe u shprehën: "Na ka munguar shkalla e vigjilencës, kemi pasur tulla të të kundërshtuar, në disa raste në punën tonë kemi vënë jashtë kontrollit të Partisë, ne nuk kemi pasur nuhatjen e duhur për rastet kur janë shkelur normat e Partisë dhe ligjet e shtetit, vigjilencën ne e kemi kërkuar tek të tjerët vetëm jashtë organit, duke menduar se ne jemi të imunituar nga gabimet dhe influencat armiqësore, kemi harruar se lufta e klasave zhvillohet edhe në gjirin tonë dhe parimin beso e kontrollo, nuk e kemi realizuar në tërë punën tonë të përditshme. Për shembull, urdhërat dhe udhëzimet që vinin nga Ministri ne nuk i kemi ballafaquar me mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha.

Disa të tjerë u shprehën: "Nga mungesa e përgatitjes ideopolitike në disa raste kemi uhazuar disa veprime dhe metoda jo të partishme të armiqësorë, Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu, Feçor Shehu, etj, kemi ndrydhur dhe zbehur kritikën brenda organit e deri brenda organizatave bazë të partisë, disa gjëra që nuk shkonin dhe që në bisedonim me njëri tjetrin, nuk guxonim që t'i thonim në rrugë shtetërore dhe në Partij, jemi influencuar nga sjelljet arrogante të armiqëve të cilat i kemi përdorur në disa raste me vartësit tonë, etj.

Puna e organeve të Sigurimit është orientuar me metodën dhe format e tyre të kamufluara që të përqëndrohej më shumë tek agjitacioni e propaganda armiqësore, dhe kjo kërkohej me forcë. Vlerësimi i punës bëhej nga numri i goditjeve pamvarsisht se në çfarë drejtimi ishin këto goditje.

Kjo ka bërë që goditjet të jenë drejtuar kryesisht në agjitacionin e propagandën armiqësore ku ka pasur edhe shumë të arrestuar bile nganjëherë edhe të arrestuar pa dinjitet, me të meta, etj. Në periudhën 1971-1981 janë realizuar 281 subjekte për krimet që ka ndjekur Sigurimi, por prej tyre vetëm 12.9 % me arrestim kanë qenë nga shtresat e pasura dhe 61.6 % nga shtresat e varfëra dhe të mesme, nga këta të fundit mundet që individë të veçantë të ishin shpëtuar nga dënimi me burg nëpërmjet këshillimit. Për të rritur numrin e të dënuarëve për agjitacion e propagandë, ka pasur raste që i njëjti dëshmitar është përdorur 3-4 herë, apo ka pasur të arrestuar në raste të veçanta që janë çuar në gjyq vetëm me një provë.

Punonjësit e Sigurimit kanë bërë presion ndaj hetuesisë që çdo dosje e hapur për ta parë hetimi të përfundonte patjetër me arrestim dhe çuarje në gjyq. Bashkëpunëtorët, deri sa du-

allën konkluzionet e Byrosë Politike në janar 1981 nuk janë përdorur gjithnjë për të sqaruar element të veçantë me përbërje të mirë që kishin folur ndonjë fjalë armiqësore me qëllim që të hiqte dorë dhe të vinte në rrugë të mbarë. Nga ana tjetër në praktikën e këshillimeve të përdorura nga ana e Degës gjatë periudhës 1976-1981, në 335 persona na të këshilluar ka pasur disa raste që këshillime janë bërë edhe për element të shtresave të pasura, në kundërshtim me kriteret e caktuara.

Shokët e Hetuesisë kanë ngritur problemin se edhe kur ata nuk e kanë parë të drejtë arrestimin për të cilin në ndonjë rast nuk ka qenë dakort prokurori i rrethit, i është dërguar dosja Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet Ministrisë, i cili ka urdhëruar arrestimin.

Në kundërshtim me klauzolën e Byrosë Politike për vartësinë administrative të Hetuesisë nga Kryetari i Degës, gradualisht nëpërmjet urdhërave e udhëzimeve të Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu, Hetuesia u vu në vartësi të plotë të kryetarit të Degës së Brendshme dhe detyruar sektorin e hetimit të marrë pëlqimin e tij për veprimet kryesore që ajo bënte. Në rastet kur sektori operativ kërkonte arrestimin e e personave me prova të zbehta dhe Hetuesia nuk ishte dakort, drejtuesit e Ministrisë me

drejtimit me porosi të Feçor Shehut kanë thënë: "Mos u merrni me vllëht, boll keni goditjet për spiunazh, por u ulni në 2B". Në një rast kur flitej për një agjent të mundshëm të moshuar, Hodo Hodaj (kryetar dege në Ministri), është shprehur: "Po juve, me pleqë e Lidhjes së Prizrenit merreni".

Në muajin mars të vitit 1981, në telegramin që dërgoi Feçor Shehu theksonte: "Çfarë po bëhet, se hetuesisë nuk po i vinë propozime. Ka rënë në ndjekjen e probleme aktive për realizimin e përpunimeve, e cila duket edhe në propozimet e pakta që këtu muajt e vitit 1981 i keni bërë Ministrisë". Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu i kanë dhënë udhëzime Hetuesisë që "asnjë i pandehur të mos dërgohet në gjyq në gjendje mohimi", ose tjetra që thoshte Feçor Shehu, se: "kush pushon çështjen, i ka hipur kalit në trockizëm".

Nëpërmjet kërkesave të shumta për studime dhe analiza të ndryshme dhe detyrave që diktonin nga lart këta armiq krijonin mbingarkesë dhe burokraci të

tepruar për të mos u marrë me problem thelbësore siç ishin ato të spiunazhit. Jemi influencuar dhe kemi bërë gabime nga metoda e dhe veprimtaria e udhëheqjes së Ministrisë. Për shembull u krijua tek punonjësit e Sigurimit mendimi se mund të jesh i mirë dhe në rregull po realizove arrestime. Po se si ishin këto, të ç'drejtimi dhe a duheshin bërë gjitha, pavarësisht se fajësia ishte, është fjala për agjitacion e propagandë, këtë nuk e shihnim. Kjo na ka çuar në njëanëshmëri, bile me pasoja, se të prirë nga më e lehta, duke rënë në disa raste dhe në ekstremizëm në fushën e agjitacionit e propagandës, kemi lënë pas dore një nga detyrat e rëndësishme, zbulimin dhe goditjen e agjentëve të zbulimeve të huaja. Me metodën e tyre drejtuesit e Ministrisë, sidomos Kadri Hazbiu e Feçor Shehu, na kanë bërë shpesh të linim pas dore kryesoren dhe të merreshim me anësore dhe vogëlsira. Për shembull, ata të bënin gjëmën kur ndodhte ndonjë arratisje, gjë që s'duhet të ndodhë, por ata

2. Disa nga drejtimit ku është pasqyruar kulti i kuadrove të organit

Gati në të gjitha organizatat bazë të Partisë u ngrit se ekziston kulti në kuadrot, veçanërisht në atë të Sigurimit e të Hetuesisë, si kuadro "më të mirë", "më të besueshëm", "të pakontrollueshëm", "të pagabueshëm", "që të bëjnë gjëmën". Me veprimet e tyre disa kuadro të Sigurimit mundohen të krijojnë bindje tek të tjerët se ata bëjnë gjithçka dhe janë në korrent të plotë të çdo problem, se bëjnë punë "speciale", e punëra "të mëdha". Eshte krijuar kulti se si punonjësit të Ministrisë së Punëve të Brendshme jemi të paprekshëm e gradualisht u krijua koncepti se tek ata nuk ndikon ideologjia e huaj borgjeze, nuk kuptohej se ata janë objekt dhe subjekt i luftës së klasave.

**SEKRETARI I PARE I KOMITETIT PARTISE SE RRETHIT**  
**ENVER HALILI**  
**(vijon)**

## REGJISTRIMET NË GJIMNAZE

### INTERVISTA

Drejtoresha: Afati i fundit i pranimeve, dokumentacioni që nevojitet

# Nisin regjistrimet në gjimnaze, fluks kërkesash te "Sami Frashëri"


*Teuta Dobi: Ja kriteret që duhen plotësuar nga nxënësit*

Voltiza Duro

Prej disa ditësh kanë nisur regjistrimet në gjimnaze për të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", drejtoresha e një prej gjimnazeve më të kërkuara në kryeqytet, Teuta Dobi tregon se numri i kërkesave i ka tejkaluar pritshmëritë. Deri më tani numri i nxënësve që nuk vijnë nga 3 shkollat e përcaktuara, ka arritur në 550, në një kohë që kuotat në këtë gjimnaz janë mesatarisht 500. Por drejtoresha sqaron se kanë përparësi për t'u regjistruar nxënësit që sipas MASR vijnë nga shkollat 9 vjeçare "Fan Noli", "Servete Maçi" dhe "Lidhja e Prizrenit". Regjistrimet do të vijojnë deri në fillimin e shkollës, ndërkohë që për t'u bërë pjesë e gjimnazeve mjafton vetëm dëftesa e lirimt. Ndërkaq Dobi bën me dije, se sipas kurrikulës së re, në vitin e parë 28 orë janë bërthamë, ndërsa 2-4 orë janë në dispozicion të lëndëve me zgjedhje ku përfshihen gjuhë e huaj e dytë; por nxënësi ka të drejtë të zgjedhë edhe artet apo ndonjë modul kurrikular sipas mundësive që ofron shkolla.



Teuta Dobi, drejtoresha e shkollës "Sami Frashëri"



Faksimile e formularit të regjistrimit

**do të ofrojë ky gjimnaz për vitin e parë? Sa nxënës mund të regjistrohen në total?**

Sipas parashikimit, në gjimnazin "Sami Frashëri", për vitin e ri mësimor 2018-2019, do të regjistrohen rreth 500 nxënës. Vlen të theksoj se sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, fillimisht duhet të bëhet regjistrimi i nxënësve që vijnë nga shkollat 9-vjeçare që iu takon, përkatësisht bëhet fjalë për 9-vjeçaren "Fan Noli"; "Servete Maçi" dhe "Lidhja e Prizrenit". Numri i regjistrimeve nga shkollat që iu takon të vijnë në këtë gjimnaz në ditët e para ka qenë paksa e ulët, e kjo besoj për faktin se ata e kanë të qartë që do të jenë pjesë e "Sami Frashërit".

**A mund të regjistrohen nxënës në "Sami Frashëri", të cilët nuk kanë qenë pjesë e një prej tre shkollave 9-vjeçare të sipërpërmendura?**

Hapësira për të marrë nxënës jashtë kriterëve që përmenda më sipër, është shumë e kufizuar. Por mund të pranohen nxënës që vijnë nga po e njëjta një-

si bashkiake dhe mesatare. Duke qenë se jemi një shkollë elitare, në mund të zgjedhim dhe kërkujmë që të arrijmë rezultate të shkëlqyera. Pra, nëse nxënësi është banor i lagjes, dhe i ka notat të gjitha 10-ta, mund të pranohet në Sami Frashëri. Është mirë që t'u japim mundësinë e këshillave. Kështu që kërkoj mirëkuptimin e të gjithë prindërve pasi nuk mund të plotësohen kërkesat e tyre gjithmonë.

**Sa është numri i nxënësve që kanë aplikuar në këtë gjimnaz, por që nuk i plotësojnë kriteret për t'u bërë pjesë e tij?**

Deri më tani, numri i nxënësve, që kanë kërkuar të regjistrohen në "Sami Frashëri" edhe pse nuk i plotësojnë kriteret (nuk vijnë nga shkollat e përcaktuara) ka arritur në 550. Por normalisht do të zbatohet me përpikëri udhëzimi i MASR dhe i vetë ministres Nikolla, ku theksohet se numri i nxënësve në klasa nuk duhet të jetë më shumë se 35. Kuptohet se në një klasë me 45 nxënës ngarkesa për mësuesin

#### KURRIKULA

Sipas kurrikulës së re, në vitin e parë 28 orë janë bërthamë, ndërsa 2-4 orë janë në dispozicion të lëndëve me zgjedhje ku përfshihen gjuhë e huaj e dytë; por nxënësi ka të drejtë të zgjedhë edhe artet apo ndonjë modul kurrikular sipas mundësive që ofron shkolla.

Në gjimnazin "Sami Frashëri" janë edhe 2 klasa që mësojnë sipas një projekti gjerman. Cilat janë kriteret për t'u bërë pjesë e këtij projekti për të gjithë të interesuarit?

Projekti gjerman në Sami Frashëri merr 2 klasa, 2 paralele në çdo vit, por ky projekt fillon që në klasën e pestë fillore përkatësisht në shkollat 9-vjeçare "Fan Noli", "Avni Rustemi" dhe "Jeronim de Rada", që shkojnë rreth 90 nxënës. Këta të fundit në klasën e nëntë në muajin mars i nënshtrohen një testimi, DSD1. Nga praktika e këtyre viteve, rreth 50% e nxënësve arrijnë ta kalojnë provimin për të vazhduar shkollën te projekti gjerman në gjimnazin tonë. Aktualisht për vitin e ri mësimor 2018-2019 kanë fituar 44 nxënës, pra me 22 nxënës çdo klasë. Vlen të theksoj se nxënësit duhet të kenë një nivel shumë të mirë të gjuhës gjermane pasi ka lëndë që zhvillohen në gjermanisht.

**Si po e pret gjimnazin juaj vitin e ri shkollor? A janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të pritur nxënësit?**

Gjimnazi "Sami Frashëri" po e pret vitin e ri shkollor me shumë ndryshime infrastrukturore, pra është punuar natë e ditë. Dyert u ndryshuan, ambientet e brendshme të shkollës po lyhen, fasada e jashtme është gati, terreni sportiv u rehabilitua po ashtu. Ndërkohë po bëhet izolimi i terracoës. Shkolla është gati për të pritur nxënësit, si nga ana infrastrukturore dhe ajo e stafit pedagogjik. Planet mësimore janë të ndara, çdo nxënës e di ku do të orientohej. Kemi bërë dhe planin për provimet e vjeshtës (për nxënësit mbetës në klasat e X dhe XI).

#### i regjistrimeve në gjimnaze?

Regjistrimet do të vijojnë deri në fillimin e shkollës, por nëse plotësohen kuotat nuk ka kuptim që procesi të vazhdojë më tej. Deri më tani kanë kaluar pritshmëritë e kërkesave e aplikimeve për t'u bërë pjesë e këtij gjimnazi.

**Cilat janë disa prej lëndëve me zgjedhje që mund të zgjedhin nxënësit e vitit të parë për vitin e ri mësimor 2018-2019?**

Sipas kurrikulës së re, në vitin e parë 28 orë janë bërthamë, ndërsa 2-4 orë janë në dispozicion të lëndëve me zgjedhje ku përfshihen gjuhë e huaj e dytë; por nxënësi ka të drejtë të zgjedhë edhe artet apo ndonjë modul kurrikular sipas mundësive që ofron shkolla. Sipas meje, më fitimprurëse dhe më me interes për nxënësit, është që të dalin me dy gjuhë të huaja nga shkolla e për këtë arsye, në 13 paralele, ndahen me gjuhë të parë (anglisht) dhe gjuhë të dytë (gjermanisht, frëngjisht apo italisht). Ndërkohë është edhe një klasë tjetër që ka gjuhë të parë frëngjishten.

Sipas parashikimit, në gjimnazin "Sami Frashëri", për vitin e ri mësimor 2018-2019, do të regjistrohen rreth 500 nxënës. Vlen të theksoj se sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, fillimisht duhet të bëhet regjistrimi i nxënësve që vijnë nga shkollat 9-vjeçare që iu takon, përkatësisht bëhet fjalë për 9-vjeçaret "Fan Noli"; "Servete Maçi" dhe "Lidhja e Prizrenit".

Është shumë më e madhe, nuk mund të realizohet një proces normal mësimor pasi nuk iu bie as radha nxënësve që të pyeten.

**Kur është afati i fundit**





## MJEKU POPULLOR



Kuroni infeksionet  
me mjaltë  
e propolis blete

## KESHILLA



Mashurkat, burim  
hekuri për një  
organizëm  
të shëndetshëm

# Rezart Xhani:

◆  
Mjeku  
urolog pranë  
QSUT-së: Ja  
simptomat  
kryesore që  
shfaqin  
pacientët e  
sëmurë



## Zmadhimi i prostatës, trajtimi medikamentoz dhe kirurgjikal

"Kujdes, kur duhet të  
paraqiteni te mjeku specialist"

### 6 mënyra efikase për të kontrolluar urinë

Voltiza Duro

**Z**madhimi i prostatës, e quajtur ndryshe edhe hiperplazia beninjë është një ndër problemet më të shpeshta të meshkujt. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku urolog në Shërbimin e Urologjisë në QSUT, Rezart Xhani tregon se ka dy tipa simptomash të sëmundjes. Më tej ai thekson se pacientët duhet të kryejnë diagnostikimet përkatëse të urologu si dhe të fillojnë trajtimin me medikamente të sëmundjes. Ndërkohë në rastet kur dështon kjo lloj terapie dhe pacienti nuk ka asnjë përmirësim klinik, rruga e vetme është ndërhyrja kirurgjikale.

**Cfarë është zmadhimi i prostatës?**

Hiperplazia beninjë e prostatës është zmadhimi i prostatës si pasojë e rritjes së adenomës, e cila ndodhet në brendësi të saj. Adenoma është një strukturë, e cila rrethon plotësisht uretren (kanalin ku kalon urina) duke dhënë një shtypje të saj.

**Cilat janë simptomat kryesore të kësaj sëmundjeje?**

Ka dy tipa simptomash të sëmundjes, ato që lidhen me vështirësinë e zbrazjes së vezikës urinare, ulje të presionit urinar që është edhe një nga simptomat më të shpeshta që referojnë pacientët. Kjo ulje e presionit ndodh aq gradualisht sa që ka ndodhur që pacientët të vijnë të bllokuar pa vënë re asgjë më parë. Simptomë tjetër është shtrëngimi për të filluar urinimin në mënyrë që të tejkalohet efekti i shtypjes së adenomës mbi kanalën e urinës. Gjithashtu, këta pacientë referojnë për mbetje të urinës pas urinimit. Pacientëve ju duhet të urinojnë çdo 1 orë më pas çdo 30 min e kështu me radhë në varësi të stadi të sëmundjes. Gjithashtu, kemi edhe urinimin gjatë natës, por duhet pasur kujdes, sepse simptomat e zmadhimit të prostatës nuk janë numri i urinimeve gjatë natës, por është sasia e urinës që eliminohet gjatë aktit mikSIONAL. Kjo sepse gjatë natës bëhet filtrimi i urinës në veshkat tona duke shkaktuar urinime, pra me pak fjalë duhet të dallojmë shpeshësinë e urinimit me sasinë e urinimit. Simptomat tjetër e rëndësishme është



Mjeku urolog pranë QSUT-së: Ja simptomat kryesore që shfaqin pacientët e sëmurë

# Rezart Xhani: Zmadhimi i prostatës, trajtimi me medikamente dhe kirurgjikale

*"Kujdes, kur duhet të paraqiteni te mjeku specialist"*

të ajo që quhet "simptoma e garazhit", e cila konsiston në urgjencën për të urinuar sapo kemi parkuar makinën dhe ngrihemi për të dalë jashtë saj. Disa herë moszbrazja e mirë e vezikës urinare shoqërohet dhe me pika urinimi të pavullnetshme.

**A ekziston një lidhje midis hiperplazisë beninjë të prostatës dhe tumorit të saj?**

Tumori i prostatës është shumë i shpeshtë për shkak se ne jetojmë në kohën e depistimit të PSA (hormoni specifik i prostatës) i cili ka rritur ndjeshëm diagnostikimin e tumoreve të prostatës. Duhet thënë në mënyrë të qartë se tumori i prostatës dhe hiperplazia e saj nuk kanë asnjë lidhje por mund të ndodhë që të dyja këto patologji të jenë të pranishme tek i njëjti person. Kjo e bën të domosdoshme që mjeku i familjes apo mjeku specialist (urolog) të bëjë diagnozën diferenciale të këtyre sëmundjeve dhe jo siç ndodh rëndom ku pacienti vetëinterpretuar vlerën e PSA duke u bazuar në internet.

**Kur është i domosdoshëm fillimi i mjekimit për hiperplazinë beninjë të prostatës?**

Trajtimi bëhet i domosdoshëm kur kemi ndryshim të cilësisë së jetës (klasifikim sipas organizatës botërore të shëndetësisë OBSH). Simptomat e hiperplazisë nuk janë si temperatura që shkon menjëherë nga 0 -40 gradë, por përkundrazi ato janë të ngadalta dhe progresive duke bërë që pacienti të mos shqetë-



Mjeku urolog, Rezart Xhani

sohet dhe të mos i drejtohet mjekut.

**Kur duhet të trajtohen pacientët me medikamente dhe për sa kohë?**

Sipas mendimit tim trajtimi i hiperplazisë beninjë të prostatës duhet të jetë i hershëm. Aktualisht ekzistojnë medikamente që kanë dy mënyra të ndryshme veprimi. Një grup medikamentesh vepron mbi volumin e adenomës, këtu bëjnë pjesë inhibitorët e 5-alfa-reduktazës, e cila është një enzimë që shndërron testosteronin në dihidrotestosterone. Duke bllokuar këtë enzimë ne bllokojmë rritjen e adenomës. Në grupin tjetër bëjnë pjesë

medikamentet që veprojnë mbi simptomat duke bërë të mundur "zgjerimin" e kanalit të urinës si tamsulosinë, alfuzosinë etj. Në rastin e alfa-bllokuesve veprimi është brenda 24 orëve duke bërë që pacientit t'i duket sikur i ka ndryshuar jeta, por, në fakt, ka ndryshuar vetëm simptoma. Në rastin e inhibitorëve të 5-alfa-reduktazës veprimi arrihet pas 6 muajsh. Pra përdorimi i këtyre medikamenteve zgjat për një kohë të caktuar apo për gjithë jetën? Këto medikamente na lejojnë të kuptojmë nëse mjekimi po funksionon (3-4 javë për alfa-bllokuesit dhe 3-6 muaj për inhibitorët e 5-alfa-reduktazës).

Aktualisht në Europë ka medikamente që i bashkojnë këto dy mjekime në një tabletë (Duodart).

**Në cilat raste është i nevojshëm realizimi i një operacioni?**

Në radhë të parë pacienti nuk duhet operuar në rast se nuk është nënshtruar trajtimit me medikamente. Ekzistojnë protokolle të qarta të shoqatës europiane të urologjisë të cilat duhen zbatuar me korrektesë dhe ndershmëri nga të gjithë urologët. Kështu operacioni është i nevojshëm kur dështon terapia mjekësore dhe pacienti nuk ka asnjë përmirësim klinik pavarësisht se është nën terapi, kur pacientit i vendoset një kateter urinar, kur kemi praninë e infeksioneve, praninë e gurëve në vezikën urinare, shfaqjen e divertikuljeve dhe në fund insuficienca renale e shkaktuar si pasojë e obstruksionit.

**Kush janë teknikat kirurgjikale të cilat përdoren në rastin e kësaj patologjie?**

Standardi i artë është rezeksioni trans-uretral i prostatës, më pas të gjitha teknikat e tjera (TUI-p, Vaporizimi i prostatës, rezeksioni Green-light etj) janë zhvilluar duke pasur për bazë këtë teknikë dhe për ta bërë operacionin sa më të sigurtë për pacientin. Duhet theksuar se në rastin e prostatave më të mëdha se 80 gram duhet preferuar kirurgjia e hapur ose ajo që quhet adenomektomi trans-vezikale.



Voltiza Duro

**P**ropolisili i bletës është një nga medikamentet më të vjetra e më të njohura nga njerëzimi, është një përzjerje substancash regjese, gome e balsamike që bletët e mbledhin në sythet apo në lëkurën e disa bimëve, duke e transformuar, me anë të sekrecioneve të tyre në një produkt të veçantë. Në përbërjen kimike të propolisit bëjnë pjesë rrëshira, balsami, dylli, vajrat eterikë, poleni dhe lëndë organike dhe minerale. Në të gjitha lëndët që përmban propolisili më të rëndësishmet janë flavonet, ku në 50 që janë zbuluar te ky medikament, 19 prej tyre janë bioaktive që luajnë efektin terapeutik të propolisit. Ndërsa në hirin e këtij të fundit, janë gjetur lëndët minerale si hekuri, magnezi, kaliumi, alumini, ndërsa ndër vitaminat numërohen vitamina B1, PP, provitamina A. Propolisili rekomandohet të përdoret kundër diabetit; ftohjes; kisteve; alergjive; infeksioneve të gojës, veshkave apo tëmthit. Gjithashtu, luan një rol të rëndësishëm në kurimin e kolitit, ulçerës, mykut dhe kribave të zorrëve, por gjen përdorim edhe në trajtimin e hazmatikës së fytyrës dhe reumatizmit. Ky medikament ndihmon në kurimin e disa sëmundjeve të tjera si astma, spondiliartroza, parkinsoni apo hernia diskale. Propolisili është një kombinim komponentësh me natyrë aromatike e fenolike, të pasura me një numër të madh substancash të shumëllojshme mes tyre. E veçanta e këtij medikamenti qëndron në pasurinë e madhe të flavonoideve, falë të cilave propolisili siguron veçorinë antimikrobike. Sipas disa studimeve, rreth 1/3 e fraksioneve të propolisit të tretshëm në alkol etilik, ka natyrë flavonoide, mes të cilave është identifikuar galangina dhe pinocebrina. Këto të fundit kanë efekte shumë të mira bakteriostatike që përfaqëson veprimin antihelmues.

**VEITTE**

Eksperimente të panumërta kanë dëshmuar se si drejtpërdrejt, ashtu edhe në të kundërt, kapaciteti i propolisit në solumione alkolike me përqindje 10-20% vepron në mënyrë efektive për të ndihmuar në ndalimin e zhvillimit të baktereve të ndryshme. Preparatet me bazë propolisin, kanë rezultuar veçanërisht aktive kundër infeksioneve candida, tricollit dhe microspori, të cilët janë në gjendje të provokojnë sëmundje të shumta parazitare mbi njeriun apo dhe kafshën. Veprime të tilla i detyrohen acidit kafeik, pinocebrinës dhe benzi-p-cumarolo. Gjithashtu, propolisili paraqet një veprimtarë parandalues në kufijtë e disa llojeve herpes, corona virus dhe në rreth 10 lloje të infeksioneve të ndryshme. Vlen të theksohet fakti, se ky medikament është përdorur



Mjeku popullor: Lëkurë e shëndetshme, përbërësit që iu duhen për maskën e fytyrës

# Ylli Merja:

## Kuroni infeksionet me mjaltë e propolis blete

*"Receta për rënien në peshë; efekte të menjëhershme"*



Ylli Merja

gjithmonë edhe për rigjenerimin e indeve në rast plagosjeje. Në rastet kur përdoret ky medikament, është fuqizuar njëkohësisht edhe veprimtaria e vaksinave, si ato kundër tifos.

**EFEKTET E MJALTIT**  
Mjalti ndihmon në uljen në peshë sepse krijon ndjesinë e të ngopurit, e nëse përdoret rregullisht ndikon në aktivizimin e hormoneve që kontrollojnë urinë. Ky produkt është burim natyral energjie pasi përmban shumë sheqerna dhe nëse merrni me sport mund të hidhni pak mjaltë në ujën që konsumoni, kështu i jepni ushqimin e duhur

qelizave, dhe rritni energjinë e përgjithshme trupore.

**MJALTË ORIGJINALE APO JO?**  
Është e vështirë të dallohet nëse mjalti është origjinal apo jo, por nuk është e pamundur. Për të dalluar mjaltin në kushte shpëtie ndiqni disa hapa. Hapi i parë është të shikoni rrjedhshmërinë e tij kështu që merrni një lugë e futeni në mjaltë, mbusheni dhe pastaj filloni ta derdhni. Nëse mjalti rrëshqet menjëherë atëherë nuk është origjinal, por ka përmbytje sheqeri. Mjalti origjinal është i dehidratuar, derdhet ngadalë nga luga, edhe pse

mund të jetë mjaltë i shkrire. Mjalti origjinal përmban sheqer, por nuk është ngjites në duar e rrëshqet lehtësisht në dorë. Ndërsa nëse lyeni dorën me sheqer me pak ujë do t'i ndjeni duart që t'ju ngjiten me njëra-tjetrën. Prandaj edhe mjalti që ka përmbytje sheqeri është shumë ngjites. Hapi tjetër është shija. Nëse mjalti është origjinal shija e tij largohet shpejt ndërsa mjalti i sheqerit qëndron në gojë, dhe ju lë shijen e ëmbëlsisë për një kohë të gjatë. Mund të kontrolloni tretjen e mjaltit në një gotë ujë me temperaturë ambiente. Merrni një lugë vetëm të ljer me mjaltë dhe futeni në ujë. Mjalti i sheqerit fillon të shkrihet menjëherë pas 2-3 rrotullimeve të lugës, ndërsa mjalti origjinal qëndron dhe akoma nuk ka filluar të largohet nga luga. Një test tjetër është ta futni mjaltin në ngrirje për 2-3 ditë. Nëse krijon kokrriza pasi e nxirrni nga ngrirja dhe ka shkrire plotësisht atëherë ai ka përmbytje sheqeri.

**PËRDORIMI I MJALTIT**

Mjalti këshillohet të përdoret në mëngjes dhe gjatë ditës, por jo në darkë pasi mund të ndikojë në shtimin në peshë. Megjithatë nëse duhet të përdorni sheqer në darkë mund ta zëvendësoni atë me pak mjaltë. Përdorimi i mjaltit për infeksionet e fytyrës është shumë i këshilluar, dhe mund të përdoret siç

është apo në çaj me pak limon. Receta me mjaltë për dobësim dhe uljen e yndyrave: Merrret 1 kg mjaltë, në të shtohen 2 luge gjelle xhinxher i thatë, i bluar, 1 luge gjelle shafrafrin, 1 luge gjelle çaj jeshil i bluar, 1 lugë gjelle fara liri e bluar, 2-3 lugë gjelle uthull mole dhe 1 lugë gjelle kanellë e bluar. Lihet përzjerja të qëndrojë për 3 ditë dhe pastaj konsumohet siç është një luge gjelle në ditë në mëngjes dhe pas saj konsumohet 2 gota ujë.

**MASKË ME MJALTË PËR FYTYRËN**

Kjo maskë mund të përdoret nga të gjitha llojet e fytyrave, ndihmon në zbutjen e lëkurës, rigjeneron qelizat e fytyrës dhe ka veprim antibakterial. Maska nxit qarkullimin e gjakut, dhe parandalon infeksionet në lëkurë, rrudhat dhe aknet. Kjo maskë është për 2 herë përdorim. Kështu merrni 1 lugë mjaltë; gjysmë luge kanellë; një majë luge piper i zi, i bluar dhe gjysmë luge shafrafrin. Përzihen të gjitha bashkë dhe aplikohet në fytyrë, pasi e keni larë me ujë të vakët. Lihet të qëndrojë 30 min. dhe pastaj hiqet me një peshqir dhe ujë të ngrohtë.



# 6 mënyra efikase për të kontrolluar urinë

Të gjithë ata që kanë probleme me peshën e tepërt duhet të dinë se gjumi i mirë, pirja e sasive të mëdha të ujit dhe aktiviteti fizik janë rregullat e arta të humbjes së peshës. Në vijim ju sjellim disa mënyra të pazakonshme për ta kontrolluar urinë. Ndonjëherë, pa marrë parasysh se sa shumë përpiqemi t'iu përmbahemi këtyre rregullave, urinë thjesht nuk mund ta frenojmë dhe e gjitha që mendojmë është ajo pjesa e fundit e tortës në frigorifer ose qesja me patatina, transmeton koha.net. Nëse nuk keni kohë të mbani një ditar të ushqyerit dhe ta regjistroni çdo kafshatë që hani, provoni disa nga truket që ju sjellim, dhe të cilat me siguri do t'ju ndihmojnë për ta mbajtur urinë nën kontroll.

## 1. HANI NJË MOLLE PARA USHQIMIT

Vetëm një mollë në ditë para vaktit kryesor mund t'ju ndihmojë që t'i shmangni sulmet e urisë. Studimi, i cili përcolli njerëzit që e kanë respektuar këtë këshillë ka treguar se ata mesatarisht kanë konsumuar 187 kalori në ditë më pak sesa ata që nuk kishin ngrënë molla. Mollët jo vetëm që përmbajnë fije dietetike, por edhe kërkojnë përtypje më të gjatë e cila është dëshmuar që shkakton ngopje.

## 2. PINI ÇAJ DHE PRISNI GJYSMË ORE

Shumica prej nesh nga monotonia, stresi apo emocionet, hamë edhe atëherë kur nuk ndiejmë uri. Provoji që në këto momente në vend se të hani ndonjë biskotë apo ndonjë qese me ushqime jo të shëndetshme, të pini çaj të zi. Studimet kanë treguar se 47 për qind e të anketuarve në këto situata kanë pasur rënie të hormonit kortizol, i cili ndikon në uri. Pini çaj, prisni gjysmë ore dhe në qoftë se pas kësaj ende ndiheni të uritur merrni diçka për të ngrënë.

## 3. HANI MËNGJES MIRE

Kapërcimi i mëngjesit mund të duket si një mënyrë e shkëlqyeshme për konsumimin e më pak kalorive në ditë, por shumë studime kanë treguar se kjo është larg nga e vërteta. Një mëngjes i mirë mund të çojë në një ndjenjë të reduktuar të urisë dhe dëshirës për ushqim gjatë ditës. Mëngjesi i pasur me proteina do t'ju mbajë të ngopur për një kohë të gjatë.



## 4. ZGJIDHNI ME KUJDES USHQIMIN

Jo të gjitha ushqimet janë të njëjta dhe bëni mirë kujdes se si i konsumoni kaloritë. Për shembull, 100 kalori të bollgurit do t'ju ngopin

shumë më shumë se 100 kalori të patatinave. Truku është që të gjeni ushqime që do t'ju ngopin më mirë me sasi më të vogla të kalorive. Ushqimi ngopës është ushqimi i pasur me fibra dhe proteina si

fasulet, patatet me lëkurë, produktet e arrave, kokoshkat, portokali dhe supa.

## 5. ECNI

Kur e ndieni nevojën për ëmbëlsira apo ushqime të pashëndetshme,

dilni për një ecje 15 minutash. Një studim ka treguar se njerëzit që kanë ecur përpara se të hanë çokolatë, kanë konsumuar gjysmën e kalorive më pak se ata që nuk kishin ecur.

## 6. AROMAT

Nuhatja e aromave të këndshme mund ta reduktojë urinë, dhe më të mirat janë dëshmuar aromat e portokallit dhe vaniljes sepse ato ndikojnë në dëshirën për ëmbëlsira. Aroma e jaseminut është dëshmuar se redukton dëshirën për çokolatë, ndërsa menta e ndalon plotësisht oreksin. Me ushqimet e duhura ju do të ndiheni të ngopur, ndërsa formën tuaj fizike do ta arrini pa shumë stres. Uria e madhe mund të lidhet me një dietë të gabuar. Transformojini zakonet tuaja të këqija, sepse kështu pasja e një forme të duhur trupore do të bëhet më e lehtë. Kur ne e ushqejmë trupin por edhe mendjen në mënyrë strategjike ndihemi më mirë, na ulet ankthi dhe zbulojmë një mirëqenie të re.





# Këshilla



## Mashurkat, burim hekuri për një organizëm të shëndetshëm

**M**ashurkat janë të pasura me hekur, ndaj rekomandohen gjerësisht për njerëzit që kanë pamjaftueshmëri të këtij minerali. Gjithashtu janë të pasura me magnez, zink, kalium, fosfor dhe kalcium, çka i bën ato perfekte për organizmin. Falë sasisë së madhe të hekurit që përmbajnë, mashurkat këshillohen të konsumohen nga njerëzit

që vuajnë nga anemia. Një gjysmë pjate me mashurka të gatuar ofron 20 kalori. Mashurkat janë, gjithashtu, një burim i shkëlqyer i sodiumit, yndyrës së shëndetshme, fibrës, kalciumit e të tjerë. Ekspertët e ushqyerjes së shëndetshme e konsiderojnë mashurkën mirëbërëse për shëndetin e njeriut. Sipas të dhënave mashurkat rekomandohen të konsumohen edhe nga

njerëzit që vuajnë nga tensioni i lartë i gjakut, niveli i lartë i sheqernave në gjak dhe kolesterolit të lartë. Mashurkat përmbajnë argininë, një substancë që ul nivelin e sheqerit në gjak dhe urinë.

Zierja e mashurkave shkatëron argininën, ndaj këto perime duhen kavërditur lehtë. Fibra e mashurkave është ideale për të përmirësuar tretjen dhe ulur kolesterolin. Mashurkat janë të dobishme për të larguar toksinat dhe substancat e padëshiruara në organizëm, sepse janë të pasura me kalium. Konsumi i rregullt i tyre rekomandohet për njerëzit që vuajnë nga reumatizma. Mashurkat mund t'i kaurdisni lehtë ose t'i gatuar me avull. Nëse i preferoni të ziera, mund t'i konsumoni bashkë me peshkun ton, mishin e pulës ose sardelet.

Për një gatim të shijshëm, mashurkat mund t'i kombinoni me trumzë, hudhër, djathë ose mish pule. Në variantin e pagatuar, mashurkat përmbajnë një proteinë që është e dëmshme dhe helmuese. Për shkak të saj, mashurkat nuk duhen ngrënë kurrë të gjalla.



## Përdorni hurmat me fara kundër rënies së imunitetit

**K**rahas shijes së tyre fantastike, hurmat mbartin vlera të jashtëzakonshme shëndetësore. Ato janë të pasura me vitamina, minerale si dhe antioksidantë si dhe përmbajnë ujë me shumicë (rreth 80%), por edhe fibra, vitamina (A, C) dhe kripëra minerale, si potas, kalcium, kalium, magnez, fosfor, selen dhe sodium. Falë përmbajtjes së këtyre substancave, hurmat u japin energji organizmit, mbrojnë sistemin imunitar, kanë aftësi të përmirësojnë tretjen dhe të luftojnë lodhjen. Hurmat janë të jashtëzakonshme edhe kundër stresit, kundër anemisë apo mungesës së oreksit. Në Shqipëri, ne mund të gjejmë nga një lloj të hurmave me fara dhe të atyre pa fara. Për fat të mirë është shumë e lehtë për të bërë ndryshimin mes të dyjave. Varieteti i hurmës me fara është si një kokërr e vogël me majë në pjesën e poshtme të saj. Ndërsa tjetri ka formën e një domateje me një gropëz të vogël në pjesën e poshtme. Konsumatorët e tregjeve të fshatarëve mund të arrijnë të gjejnë edhe hurma super farëzeza, të ashtuquajtura hurma çokollate, që quhen kështu si rezultat i ngjyrës së errët të tullit të hurmës. Në mos krenjt të errëta, njollat e kafta në tulin e hurmës janë gjithmonë shenja e dhurës se sa e mirë është hurma në shije. Ata që nuk e njohin hurmën, këto njolla të kafta i shohin si shenjë të kalbjes së frutit. Ata që e njohin mirë atë, e dinë që bëhet fjalë për të kundërtën. Për më tepër, konsumatorët mburren edhe me numrin e farave tek hurmat me njolla të kafta, sepse sa më shumë fara të ketë, aq më e shijshme është. Hurmat e freskëta dhe të pjekura mirë konsumohen direkt, por shija e tyre e veçantë i bën hurmat të gjejnë përdorim edhe në aspekte të tjera kulinarie, duke nisur nga sallatat e deri tek lëngjet e frutave. Hurmat që janë xhelatinoze në natyrë shërbehen edhe majë ëmbëlsirave në formën e shurupit.

## NE ALPET SHQIPTARE ZAKONE DHE HISTORI

Reportazh/ Histori alpesh të ashpra me njerëz të butë...

# Rrugëtim në viset e shqipëses...

*Nga Lëpusha dhe Vermoshi në Plavë e Guci*

Rezarta Delisula

A ta jetojnë mes majave të larta, në skajin më verior të Shqipërisë. Janë shtatlartë e faqekuq, për shkak të ajrit mbushur me oksigjen. Nuk janë të ashpër si klima e këtyre trojeve, por njerëz të butë e mikpritës. Nëse do t'i shpëtosh të nxehtit apo të rrëshqasësh në borë, të ushqehesh mirë e të ecësh maleve, ky është vendi perfekt. Jemi stacionuar në Lëpushë e do të shkojmë në Vermosh dhe Plavë e Guci për të parë se çfarë ndodh në viset ku flitet shqip... Rruga është tërësisht e asfaltuar dhe nga Tirana duhen 4 orë për të mbërritur në zemër të Alpeve, sigurisht bashkë me një pushim në mes.

### LËPUSHA

Është një vend fantastik vendosur mes maleve të lartë të Shenikut e Bjeshkëve të Namuna ku përmes lëndinës kalon Sheu i Lëpushës, përroi që i jep dhe dritë banorëve në rast se ndërpriten energjia, mungesa e së cilës është vërtet shqetësim serioz për vendastit. Na duket vapë edhe kur mbërrijmë në Lëpushë, por nëse futesh nën hijen e pyjeve të duhet bluzë me mëngë të gjata ndërsa në darkë xhup i trashë. Fshati ka 4 lagje me rreth 60 familje që jetojnë aty pasi një pjesë e tyre kanë emigruar. Në jemi mysafirë të Zef Nilaj ose Zeka, siç e thërrasin. Ai ka një bujtinë të pastër me tri dhoma sipër e dy poshtë, por që duhet të prenotosh disa ditë para, sepse nuk gjen vend. "Këtë vit kemi pasur shumë turistë të huaj, të cilët vijnë në çdo periudhë, ndërsa turistët shqiptarë ka pasur më shumë gjatë muajit gusht. Janë nga Austria, Gjermania, Franca, Holanda, nga e gjithë Europa, për ta përmbledhur shkurt", - thotë Zeka. Ai punon dhe në doganën shqiptare në Vermosh prej 25 vitesh e kur e pyesim për lëvizjet në këtë pikë që lidhet me Malin e Zi na thotë: "Kemi pasur shumë deri në 600-800 vetë në ditë". Ushqimi në bujtinë është i përfshirë dhe Vjollca zonja e shtëpisë bashkë me Bajrnen dhe Lolën, gatujnë bukë e ngrohta, byrekët, mishin e rritur në mal e turshitë e mazën... Vjollca ruan si sytë e ballit në një valixhe të madhe rrobën e dasmës së saj, të cilën e kanë veshur edhe gra të tjera në fshat. Ia ka trashëguar ëma, Hana dhe, është një xhubletë që ka 12 pjesë: kopicën që vendoset në kokë, rubën, postavën, grykoren, dy përshjtjellakë, xhubletën, jastëkun e



Zef Nilaj pronari i bujtinës në Lëpushë duke folur për GSH



Ndue Voku banor i Vermoshit

xhubletës, dy këmisha dhe çorapet... të gjitha të punuara me dorë. Është një veshje fantastike edhe pse kur e vesh do shumë punë. Këtë xhubletë mund ta veshin dhe turistët që duan të kenë një kujtim të vërtetë nga Alpet shqiptare. Lëpusha, në fakt, është vend plot gjallëri. Grupe të tëra turistësh shkëmbehen në rrugën e vetme të fshatit. Disa marrin djem nga Lëpusha apo siç më pëlqen t'i thërras, udhërrëfyesit e maleve, për të shkuar në Theth apo Valbonë. Kjo është hera e dytë që shkoj në Lëpushë dhe do të kthehem sërish.

### VERMOSHI

Është skaji më verior i Shqipërisë e lumi që ka marrë shumë territor na shoqëron përgjatë gjithë luginës. Kulla e Prek Calit është një ndër vendet më të vizituara në Vermosh. Në fakt, ajo kullë guri sa një treqatësh ka mbetur

vetëm një grusht kubesh të gurtë. Që kur atë e sekuestruan më 1945, vit i pushkatimit të Prek Calit si antikomunist i përjetuar bashkë me trembëdhjetë burra të tjerë, ndër to edhe Dom Ndre Zadeja, Pashka, gruaja e tij u detyrua të largohej dhe kulla u la të rrënohej. Gjithsesi historia e malësorit i tërheq turistët vendas e të huaj, të cilët të ai grumbull i gurtë gjejnë një copëz të tmerrit komunist. Sot në Vermosh janë rreth 100-150 shtëpi të banuara e ashtu si në Lëpushë vendasit kanë emigruar më së shumti në SHBA. "Duam vetëm një urë, urë që të lidhi Velipojën (fshat në Vermosh) me Vermoshin. Edhe me dritat nuk jemi mirë", - na thotë Ndue Voku. Banorët e zonës e mbajnë veten me turizëm e bujqësi. Drithërat, patatja, fasulet, lakrat dhe pemët frutore janë burimi i tyre.

### GUCI, PLAVË E VUTHAJ

Pika kufitare është fare pranë Vermoshit dhe Gucia është vetëm 14 kilometra larg. Vetëm 500 metra para Postës janë të shtruarat me çakull ndërsa pjesa tjetër është asfalt. Oficerët e shërbimit mbajnë një bllok ku shënohen emrat tanë pasi sistemi nuk punon. "Do kemi së shpejti një pikë të re kufitare të përbashkët me Malin e Zi" - na thonë policët në detyrë. Është dita e Kurban Bajramit e asgjë në viset shqipfolëse nuk pipëtin. Dyqanet janë të mbyllura e në rrugë shihen vetëm njerëz që shkojnë bëjnë vizitat sipas traditës. Mes Gucisë dhe Plavës shohim disa vajza bukursh, të veshura mirë që po kërcëjnë në oborr dhe mendojmë se kanë dasmë. Ato na ftojnë të hyjmë brenda. Jemi në shtëpinë e Balidemajve. Nuk ka dasmë, thjesht festojnë



Pamje nga Lëpusha

Bajramin. Ato janë 7 motra dhe një vëlla e të gjithë flasin një shqipe perfekte. Në fakt, nga fisi i tyre ka qenë edhe mësuesi i nderuar që i mësoi brezave të tërë shqip. Jusuf Sylë Balidemaj dhe Mehmet Ramë Balidemaj. Një nga motrat merr me shpejtësi nga frigoriferi lëngje frutash e ujë ndërsa një tjetër bakllavanë me peta të tëhollura vetë e gjalpë erëmirë. Më e madhja është tek 30-tat dhe jeton në Amerikë. "Po të vini andej mos ngurroni me më marrë", - na thotë ajo ndërsa e pason tjetra; Shtëpinë e gjeni kollaj në New York, në ballkon mban flamurin shqiptar... Duke takuar ato vajza mikpritëse menduam se të gjithë flasin shqip, por si na shpjeguan më vonë, një pjesë e madhe e shqiptarëve të Plavës e Gucisë ishin asimiluar ndër vite. Gucia apo Gusinje, siç shkruhet në gjuhën malazeze është e vogël dhe popullohet më shumë nga shqiptarë e boshnjakë. Emri i saj daton që në shekullin e 14 në defterin osman ku përmendet si stacion në rrugën, Kotor-Shkodër-Podgoricë-Pejë. Nga Gucia në Plavë janë vetëm 11 kilometra rrugë. Shtëpitë e renditura bukur mbi liqenin e Plavës dhe Alpet përreth e bëjnë edhe më fantastike pamjen. Të vetmit që hasim rrugës janë joshqiptarë ose ata që dalin nga xhamia. Kurban Bajrami ka mbledhur familjet bashkë e, si vakt dreke që është, kalimtarët numërohen e gishta. "E ruajmë gjuhën, por një pjesë janë asimiluar. Ne jena shqiptarë e fëmijët i



Shtëpitë e shqiptarëve në Vuthaj







Hal Gjonbalaj nga Vuthaj



Motrat Balidemaj



Në Kroin e Ali Pashës



Busti i Isuf Kamer Çelaj

çojmë në shkollë shqipe”, -na thotë Bajrami, i cili ka emrin festës më të madhe myslimane. Në Plavë ka edhe gjimnaz shqip ndërsa shkollën e lartë, të rinjtë e kryejnë më së shumti në Prishtinë e më pak në Tiranë.

**KROJET E ALI PASHËS (GUCISË)**

Në rrugën ngjitur me xhaminë kryesore të Gucisë, shkohet për në Vuthaj, zonë totalisht e banuar nga shqiptarë ndërsa majtas saj janë krojet e Ali Pashës. Kullën e gurit të Gjonbalajve ku ka lindur dhe vetë, Hala e ka kthyer në

restorant ku gatuan ushqime karakteristike vendase. Era e mirë e buranisë me maze (gatuar me bish-taja) na shpon hundët. Hala është grua e ditur dhe tekta na sjell një tas me boronica e akulllore mbi to, ulet të na tregojë pak për vendin e saj, Vuthajn. “Ka shumë gjëra që mund të shihen këtu. Janë krojet e Vuthajt ose të Ali Pashës dhe thuhet se ai ka pirë në to ndaj i ka mbetur ky emër; është liqeni i Hrid-it më i larti në Europë, 1970 metra mbi nivelin e detit, liqeni i Plavës në të cilin rritet një peshk i rrallë, ujëvara e Vuthajt 11 metra e thellë,

Syri i kaltër 29 metra, kemi shumë shpella atë të Kryqajve ku janë gravurat ilire 3200 vjeçare, dhe borë 3 mijë vjeçare në maja... kemi ushqime fantastike pastaj”, - thotë Hala. Ajo na shpjegon se në Vuthaj jetojnë 370 banorë që flasin shqip e ky është ndër vendet që nuk kanë pranuar të përzihen me të huajt. Kur e pyesim se si kanë mundur të ruajnë gjuhën ajo shprehet me nderim e krenari për një brez të tërë nxënësish të viteve ‘45. “Kur u mbyllën kufijtë gjuha shqipe u hoq nga shkollat dhe nxënësit e atyre viteve i braktisën

klasat malazeze e shkonin mes maleve në Shqipëri. Ky reagim e detyroi regjimin të rihapte shkollën shqipe dhe ne u jemi mirënjohës atyre brezave”, -vijon Hala. E vetmja gjë që i mungon vuthjanes së ditur është përfshirja në mbledhje e takime mes shqiptarësh të Shqipërisë për të shkëmbyer eksperiencat, kulinarinë, zakonet...

**NGA JAKUP FERRI TE ISUF KAMER ÇELAJ**

Për të shkuar në Ujëvarën e Vuthajt duhet të kalojmë në fshat ku flamuri shqiptar është thuarje në çdo balkon. Familjet më të

mëdha në zonë janë Gjonbalaj, Ulaj, Ahmetaj, Vuçetaj, Çelaj, Brucaj... Në anë të djathtë busti i Isuf Kamer Çelajt luftëtarit të paepur, po me flamur shqiptar që i valëvitet në anë, na krijon idenë se jemi brenda kufijve. Kjo trevë ka pasur trima e një prej tyre me emër të madh është Jakup Ferri. Ai ishte martuar me kushërirën e Ali Pashë Gucisë, njeriut me të cilin luftoi krah për krah, e me të kishin tetë fëmijë (pesë djem Hasani, Mehmedi, Omeri, Agani e Emini dhe tri vajza: Kusha, Bardhokja dhe Zadeja). Jakup Ferri kishte filluar veprimtarinë e tij patriotike e luftarake kudër malazezëve e turqve në vitet e pesëdhjetë të shekullit XIX, që pasuan pas reformave të Tanzimatit, kishte marrë pjesë në shumë beteja, ndërsa në vitet e shtatëdhjetë ai ishte bërë njëri nga trimat më të shquar të Malësisë së Plavës e Gucisë dhe kishte marrë pjesë në kuvende burrash. Kulla e Ferrajve ishte bërë qendër e kuvendeve ku vinin burra jo vetëm nga Plava e Gucia, por edhe nga Kosova e trojet tjera shqiptare. Ai luftoi deri në fund të jetës kundra Traktatit të Shën Stefanit ku shumë troje shqiptare u morën nga Serbia e Mali i Zi dhe ishte firmëtar në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Në betejën e fundit në breg të Limit, më 4 janar 1880, ai u plagos rëndë dhe më 11 janar vdiq në Plavë nga plagët e marra në betejë. Me pamjen e rrallë të ujëvarës së Vuthajt mbylлим udhëtimin tonë në trojet shqiptare, udhëtim që s’duhet humbur nga askush.



Opinion i Ditës

# Aleksandar Vučić, antishqiptari dinak dhe miku serb i Edi Ramës



Nga Spartak Topollaj

(vijon nga faqja 1)

...identifikojmë ata. Të vështirë do kishim pasur të kundërtën, pra gjetjen e ndonjë politikani serb, të arsyeshëm, realist dhe objektiv. Mendoj se të tillë numërohen jo më shumë se gjashtë e dorës në Serbinë e sotme, madje kurrë në nivelet e larta të shtetit apo partive politike, ndaj dhe është për këtë, që as ia vlen t'u a përmendësh emrat. Në top-listën e antishqiptarëve serbë, për një vend "nderi", mund të themi pa mëdyshje, rreshtohet katërshja kryekriminale: Milosheviç, Sheshelj, Karaxhiç dhe Mlladiç, shkatërruesit e Jugosllavisë titiste me zjarr e hekur nga Armata, Policia, Shërbimet Sekrete, paramilitarët, mercenarët e huaj rusë, apo nga ish-republikat sovjetike, me agresion, gjenocid, krime lufte, masakra, përdhunime, pogrome, deportime masive, varre kolektive, etj. etj. Në një mënyrë apo një tjetër, dashamirësi ndaj shqiptarëve, nuk treguan as Koshtunica, Drashkoviç, Taçiç, Jeremiç, etj. Ndoshta më i moderuar u tregua vetëm Zoran Xhinxiç, i vrarë nga mafia narkopolitike e Klanit të Zemunit, (ndërsa ishte kryeministër në Beograd), më 12 mars 2003! Pas të mësipërmeve, në hierarkinë politiko-shtetërore serbe po dilnin mbi ujë "nëndetëset" shovene e të sofistikuarra të tipit Nikoliç, Daçiç, Vuçiç, Tabakoviç, Brnabiç, Gjurjiç etj, ose më saktë, ata që po e qeverisin sot Serbinë. E pikërisht mes tyre, jo thjeshtë pse ishin homologë, as pse ishin meshkuj 200 centimetrash, e ish-sportistë, po për arsye që nuk i shpjegoi kurrë, e që edhe nuk është e vështirë sot të kuptohen, fort-lartësia e tij kryeministër Edi Rama, zgjedhi ta konsiderojë mik (paçka se edhe emrin nuk ia tha saktë, Aleksandar, kur ai quhet Aleksandar), një politikan plot pikëpyetje e dritëshije, të cilin, e kish takuar vetëm për pak minuta dy herë më parë! Dhe ky ishte pikërisht Aleksandar Vuçiç.

Le të shohim tani, kush është ky mik i shquar i Ramës, që në mënyrë serbe të "mikpritjes", ia ndërpreu fjalën në konferencën e shtypit, përdori "provokacija"-n dhe doli më parë se miku nga salla kryeministër në Beograd, ku edhe po zhvillohej ajo. Në përfundim të kësaj farë miqësie, ai vetëm pas disa javësh, nuk vonoi dhe e qesëndisi publikisht Ramën Edi, teksa e vlerësoi plot ironi si "Lider Global"!!

Aleksandar Vuçiç lindi në kryeqytetin serb më 5 Mars të 1970, nga prindërit, Angelko dhe Angelica Vuçiç (e lindur Milovanov). Babai, i lindur edhe ai në Beograd, me origjinë ishte nga serbët e Bosnjës Qendrore, saktësisht prej Çipuljiç, afër Bugojnos. Gjyshi ish-

te vrarë nga ustashtët. E ëma u lind në Beçej të Vojvodinës. Babai i Aleksandarit ishte një ekonomist, ndërsa e ëma gazetare. Mësimet e para i mori në Beogradin e Ri dhe e përfundoi ciklin 8-vjeçar në shkollën Branko Radiçević, ndërsa të mesmen në gjimnazin e Zemunit. Studimet e larta për Drejtësi i nisi dhe i mbaroi në Universitetin e Beogradit, pas të cilit, perfeksionoi anglishten në Brajton dhe për pak kohë punoi edhe si tregtar në Londër. Kthehet në vendin e vet dhe fillon punë si gazetar, korrespondent lufte në Pale të Bosnje Hercegovinë, ku nuk vonon të njihet e të miqësohet me famëkeqin kriminel Radovan Karaxhiç, të cilit, ka ekskluzivitetin t'i marrë edhe intervista, ndërsa miqësia me një tjetër kriminel lufte, komandantin Ratko Mlladiç, shkoi deri atje, sa edhe pse kohë lufte, të luajta shpesh shah me njëri tjetrin! Këta burgaxhinj të Hagës ishin miqtë e parë të rëndësishëm të Vuçiçit, që do pasohen nga një tjetër mik edhe më konfident se këta të dy, Vojislav Sheshelj, që u bë lider i një partie nacionaliste radikale serbe dhe frymëzues e ndihëues i ekstremistëve serbë, ndër të cilët do ditë e më tepër po binte në sy, (jo vetëm për gjashtë-inë), i riu me "perspektivë" Aleksandar Vuçiç. Për çudi, edhe ky mik i tretë i tij, u dënua si kriminel lufte në Hagë, por ndryshe nga dy të parët, me anë të një raportit mjekësor, ia doli të lirohet nga burgu, për shkak të kancerit malinj kolorektal, prej të cilit do të duhej të kish ikur prej kohësh nga kjo botë, çka jo vetëm s'ka ndodhur, duke vërtetuar falsitetin e diagnostikimit, por më keq akoma, se si i liruar me kusht nga Haga, nuk do të duhej të merrej me aktivitet politik, gjë që cilën ai po e bën për shtatë palë qëllim të tij, president aktual i Serbisë. E pra, këta janë tre miqtë e këtij miku të Ramës, të cilët i bie të jenë edhe miq të tij, në se do i referoheshim shprehjes proverbiale të popullit, që thotë se: miku i miqve të mi, është edhe miku im! Në rrinë e tij, Vuçiç ishte një fans i tërbuar i Crvena Zvezdës (Yllit të Kuq të Beogradit), klub ky famëkeq për huliganët e tipit Ivan Bogdanov, dënuar në Itali, pas ndeshjes në Xhenova të ndërprerë e të fituar në favolinë nga italianët, i cili u shfaq, edhe pse po "vuante" dënimin në Serbi, edhe në të famshmen idiotëri tashmë recidiviste huligano-futbollistike të serbëve në Beograd, gjatë ndeshjes tjetër të luajtur, e gjithashtu të ndërprerë, ndaj përfaqësueses së Shqipërisë, (14 Tetor 2014), fituar me vendimin e KAS-it të Lozanës nga përdërruesia jonë, ndeshje të cilën pata fatin e madh ta përjetoi drejtëdrejtë në tribunën e stadiumit të JNA, ndryshe i Partizanit të Beogradit, falë një miku shumë të mirë timit, diplomat i rëndësishëm amerikan në ambasadën e USA, në kryeqytetin serb. Atë mbrëmje, s'kish se si të mos me kujtohej kualifikimi historik i "Flamurtari"-t, të Vlorës pas atij supergol të Kushtës në portën e Fehrudin Omeroviqit, portierit të "Partiza-



ni"-t të Beogradit, luajtur po në këtë stadium. Duke e zgjatür pak me futbollin serb dhe Vuçiçin, miq të tij dëshmojnë, se ai ishte më shumë se një fans i Zvezdës, çka e tregoi edhe në derbin e "Dinamo"-s së Zagrebmit me Crvena Zvezdën më 13 maj 1990, ku u paralajmërua, se nga topat e futbollit, grushtet dhe shkelmat në fushë, tribuna, e jashtë tyre, do të kalohet shpejt te topat nacionaliste të artilerisë! Bëmbë baba të të ngjaj. Edhe djali i madh i Vuçiçit, u kap nga kamerat e TV, mes një grupi tifozësh huliganë serbë, gjatë Botërorit të Rusisë, por për të atin, kjo kishte qenë thjeshtë vetëm një rastësi! Vuçiç u martua për herë të parë me Ksenija Jankoviç më 27 korrik të 1997, dhe kjo një gazetare e Radio Index&Srpska rec, me të cilën patën dy fëmijë dhe u divorcuan më 2011. Më 14 dhjetor 2013 Vuçiç martohet për së dyti, si rëndom edhe shumë lider të tjerë politik të Lindjes, kur mendojnë se u janë ndalur bashkëshortet. Kësaj here me një diplomate të MPJ së Serbisë, e quajtur Tamara Gjukanoviç, e cila një javë pasi bashkëshorti i saj hyri zyrtarisht në zyrën presidenciale (31 maj 2017), lindi një djalë.

A. Vuçiç hyri në politikë me pranimin në Partinë Radikale Serbe të Vojislav Shesheljit, më 1993 duke bërë një karrierë të shpejtë, pasi vetëm dy vite më vonë zgjidhet Sekretar i Përgjithshëm i saj. Kjo ishte një parti nacionaliste e ekstremit të djathtë, më saktë një parti fashiste, që moto të saj kishin Serbinë e Madhe. Një pjesë e madhe e anëtarëve të saj ishin në avantazh të krimeve, masakrave dhe gjenocidit që serbomëdhenjtë kryen në Kroaci, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, duke i vënë damkën Jugosllavisë, si vendi ku u kryen masakrat më të mëdha e më të egra në Europën e pas Luftës së Dytë Botërore. Dhe të mos harrojmë se Sekretar i Përgjithshëm i kësaj partie, ishte Aleksandar Vuçiç. Më 1998 kjo parti, hyri në koalicion qeverisës me Partinë Socialiste të Milosheviçit dhe vetë Vuçiçit, iu dha portfoli i ministrit të Informacionit, variant serb

ky që mbulonte dhe justifikonte si Zhdanovi në Bashkimin Sovjetik të Stalinit dhe Gëbelisi në Gjermaninë e Hitlerit, sektorin e Propagandës, detyrë, që duhet pranuar, se ai e kreu me shumë devocion. Pikërisht në kohën që ky dikaster drejtohej prej tij, me propozim të vetë Vuçiçit u miratua një ligj i egër i represionit ndaj mediave (kuptohet, atyre në opozitë me regjimin), i cili binte ndesh edhe me vetë Kushtetutën e kohës. Ish-te kjo politikë që çoi deri në arrestime, burgosje, dënime, rrëjë, tortura, rrëmbime, zhdukje e deri vrasje gazetarësh, siç ndodhi edhe me më të shquarin prej tyre, Sllavko Curuvija, ( që kishte pasur raporte të pasqaruara mirë me Mira Markoviçin e Sllobos, i vrarë më 14 Prill të 1999, apo Milan Panticiç e Zada Vujasinoviç. Vetëm në Janar të 2014 policia arrestoi si të dyshuar për këto krime, dy agjentë special të Shërbimit të Sigurimit të Shtetit, Milan Radonjiç dhe Ratko Romiç, madje edhe vetë ish Shefi i madh i këtij Shërbimi me stazh 40-vjeçar Radomir Markoviç, ka pranuar implikimin e këtij Shërbimi në këto punë të pista, që kulmuan me vrasjen e Kryeministrit, Xhinxiç, ish-Prezidentit Ivan Stamboliç dhe atentantit ndaj Vuk Drashkoviçit, me ekzekutues material kolonel Milorad "Legjia" Ulemek, këtë Rambo të Legjionit të Huaj francez dhe kapo të forcave Speciale Serbe, i implikuar në të gjitha luftërat dhe krimet në Jugosllavi. Në mbyllje të këtij kapitulli, mund të themi, se në cilësinë e Ministrit të Informacionit të Milosheviçit (24 mars 1998-24 tetor 2000), Vuçiç mbërriti apogjeun e hipokrizisë dhe gënjeshtërve propagandistikë, për t'i hedhur hi syve Botës Demokratike e të Civilizuar, lidhur me krimet e përbindshme serbe në Kosovë, mision të cilin e mbyllti duke dështuar me sukses të plotë, pasi NATO, SHBA dhe BE i thanë nëpërmjet "buldozerit" Riçard Holbruk, ndal, marrëzisë së skizofrenit Sllobo, duke i detyruar ata të miratonin deri dhe bombardimin e Beogradit, e që bashkë me luftën heroike të shqiptarëve të Kosovës:

FARK, e sidomos UÇK, bashkë me udhëheqjen e urtë të Presidentit Rugova, Ghandit të Ballkanit, e gjuhëzuan përfundimisht atë dhe regjimin gjakatar stalinist të tij. Pikërisht për të gjitha këto në atë kohë, BE e futi Vuçiçin në top-listën e zezë të saj, nga e cila, ujku i vjetër serb, doli vetëm kur veshi lëkurën e qengjiti, e padyshim, edhe me ndihmën e burokratëve të madhtë të Brukselit, ku spikat dukshëm Komisionerja Federika Mogherini, dikur një ekstremiste e Vuçiçit, njohu dy humbje të rënda, kur kandidoi dy herë rresht për kryebashkiak të Beogradit, më 2004 dhe 2008 tek mundej respektivisht ndaj Nenad Bogdanoviçit dhe Dragan Gjljasit. Me sa duket beogradasit nuk e dëshën, por kjo nuk e dekurajoi, përkundrazi, mes problemesh të shumta dhe luftës së bërëryllave për pushtet, ai vazhdoi çuditërisht me sukses betejat e tij. Mjeshtrë i spërdredhjes, ai e braktisi shefin Sheshelj, i cili tashmë e shihte botën nga dritarja e vogël e qelisë në burgun Sheveningen të Hagës, i dënuar për gjenocid, krime lufte, spastrim etnik etj. Madje ai braktisi edhe vetë Partinë Radikale të tij, teksa së bashku me Tomislav Nikoliçin pas shizmit së partisë krijuan një parti të re (6 Tetor 2008), të cilës, me sa duket, për ironi i vunë emrin Partia Progresiste Serbe, që në aleancë me socialistët e Daçiçit formuan qeverinë e re, duke marrë madje edhe postin e presidentit për pesë vite, ish-varmihësi Nikoliç, por edhe Vuçiç njohu ngritje në detyrë, përdërrisa iu dha portfoli ministrit të Mbrojtjes (27 korrik 2012-2 shtator 2013, njëkohësisht dhe Zv/KM i Parë deri më 27 Prill 2014), dhe u zgjodh edhe Kryetar i Partisë Progresiste Serbe. Duke ndërruar vendet me Daçiç-in, ai merr detyrën e kryeministrit (27 prill 2014-31 maj 2017) dhe pasi e nxjerr në pension Nikoliçin, zgjidhet President i Serbisë, funksion në të cilin është edhe aktualisht. Interessant dhe mjaft domethënëse mbetet fakti, që Vuçiç, detyrë të parë i vuri vetes, marrjen në Gardën Presidenciale për sigurinë e tij, të trupave speciale "Kobra"-s, të cilat në kundërshtim me ligjin e kishin ruajtur gjatë gjithë kohës kur e kryeministër.

Qengji i sotëm Vuçiç, në 20 korrik të 1995, kur edhe ndihej ujku, i frymëzuar nga shovinizmi historik serbomadhi i Sllobos, Karaxhiçit, Mlladiçit e Shesheljit po e po, pati lëshuar kërcënimin himlerian, bash para Asamblesë Kombëtare, se për çdo serb të vrarë në Bosnje do ekzekutoheshin 100 myslimanë! Më pas, ky kameleon gjatosh, foli për keqkuptim të thënies së tij dhe si ftyrëfort që është, guxoi të shkojë në përkuajtimit e 20-vjetorit të Masakrës së Srebrenicës në Bosnje, me 8000 të vrarë, kinsë për të kërkuar një lloj faljeje, që shkodorëtanë të mënçur të humorit fin e luksoz, e përcaktojnë si: m'ka çu nana (Serbi), me la gojë! Një breshëri guresh prej prindërve të afërmeve të viktimize, u lëshua mbi kokën e Vuçiçit, një pëllëmbë më lartë se e të tjerëve, dhe falë kobrave që e mbronin me çadra,



shpëtoi paq kryekobra e Serbisë.

Në 7 tetor të 2014 kryeministri Vuçiq, me ftesë të Ramës, vizitoi Tiranën. Propaganda zyrtare e të dy qeverive e paraqiti si historike këtë vizitë, madje gabimisht e quajti të parën e një kryeministër serb në Shqipëri, duke harruar se i pari kryeministër serb që vizitonte Shqipërinë ishte Milan Paniç, njëkohësisht edhe bos serbo amerikan i prodhimeve farmaceutike (në këtë kohë Serbia ishte ende pjesë e Federatës Jugosllave, ndërsa Prof. Dr. Sali Berisha, mikpritësi i tij ishte President i Shqipërisë). Duke e ditur se ishte në fokusin e kamerave televizive, që përcillnin drejtpërdrejt vizitën, para shqiptarëve e më gjërë, Rama mbajti një qëndrim deri diku të pramshëm, por gaboi rëndë, teksa e quajti mik Vuçiq-in! Jo të gjithë miqtë e Ramës, mendoj, detrymimisht duhet të jenë edhe miq të shqiptarëve. Po për këtë do të rikthehemi në shprehemi përsëri. Rama ia ktheu vizitën mikut të tij më 27 maj 2015 në Beograd. Kësaj here "mikpritësi" Vuçiq, shpalozi atë, që serbët dinë të bëjnë më mirë, sjelljen "qytetare", leksionet për të cilën, ia ka ngarkuar shefit të djeshëm dhe vartësit të sotëm Ivica Dačić, për të cilin tashmë, vetëm pak ditë më parë kam botuar, në po këtë gazetë të rnderuar një opinion të gjatë. Vuçiq-i dukshëm gjatë konferencës së përbashkët të shtypit me Ramën shfaqti padurueshmërinë e tij deri në bezz, nuk pyeti as për protokoll e ceremonial, duke nisur të largohet para mikut të futur, që ende nuk kish mbaruar së foluri dhe që për konsum të brendshëm e karshillëk ndaj Ramës, përdori fjalën PROVOKA-CIJA!

Mbështetur në metodat tashmë të vjetëruara sovjetike, me skenar ala KGB e UDB, ka gjasa të shumta, që Shërbimi Sekret i Sigurisë së Serbisë, të ketë sajuar një atentat ndaj të porzagedhurit President Vuçiq, nëpërmjet një aksidenti të qëllimshëm automobilistik të një Bentley luksoz, brenda të cilit ishin tre persona të maskuar, që goditi makinat e autokolonës presidenciale. Analistët mendojnë se kjo ngjarje u shfrytëzua, për të spostuar vëmendjen e qytetarëve serbë nga kriza ekonomike, dëshimet politike e sidomos ngecja e negociatave me Kosovën, që irri si shpata e Damokleit mbi kokë Vuçiqit, të cilin i është bërë e qartë se pa njohjen e Kosovës, do të duhej ta harronte BE-në. Dikur thuhet për Greçinë, se ishte grauja e Lindjes dhe dashnorja e Perëndimit, ndërsa sot mund të thuhet me plot gjoën, se Serbia është grauja e Rusisë dhe dashnorja e BE! Për këtë, ka aq shumë fakte dhe argumente, sa do të duheshin faqe të tëra gazetash t'i rreshtonim, por ne do ndalem vetëm të disa syre. Në luftërat e serbëve, që quan Jugosllavinë drejt shpërbërjes e shkatërrimit, ata që i ndihmuam më shumë serbët, ishin rusët, kryesisht mercenarë, ish burgaxhinj ordinerë, pijanecë, të droguar, të degjeneruar, stalinistë e breznejvanë të deziluzionuar nga disfata në luftën 10-vjeçare në Afganistan, apo nazisikim ekstremistë, të gjithë delinkuentë të egër e të pamëshirshëm në krime. Po ashtu, Rusia dha ndihma të mëdha në armë, municione, dhe logjistikë, (kryesisht stogë ushtarake të epokës sovjetike), por edhe në financa, e të gjitha këto, në kohën kur BRSS ishte shpërbërë, po i merreshin këmbët më keq se Liderit të tyre sarhosh, Boris Jelcin. Të gjithëve u kujtohet se si nxituan trupat ruse të kapnin para tyre të NATO-s aeroportin e Prishtinës dhe si bllokuan e bllokojnë çdo rezolutë për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB, pa harruar se diplomacia e saj putiniste me Lavrovin në krye, këtë "gaspandinjet", binjak i Gromikos, lobjojnë fuqishëm por Serbisë, kundër njohjes të Kosovës, e pranimit të saj në OKB. Nga ana tjetër Çecenia, Gjeorgjia, Abkhazia, Osetia, Nagorni Karabaku, e në fund Krimea, janë shembujt më të mirë, që tregojnë se në këto pika të nxehta, Serbia i është bashkëngjitur

qëndrimeve politike dhe interesave të Rusisë, si shpërblim për ndihmën e përkrahjen e pakursyer, në këto 25 vjetë e fundit, paqka se aneksimi me forcë i Krimesë nga Putini, me agresion ushtarak të armatosur dhe kërkese e tij, që të njihet e drejta e rusëve të Krimesë për shkëputje e Pavarësi nga Ukraina, i nxjerr bluf para gjithë Botës, si Rusinë, ashtu dhe Serbinë në politikat dhe diplomacinë dy standarde të tyre, madje, jo rrallë përdoret si shantazh reciprok, në varësi të konjukturave. Nga ana tjetër, Vuçiq kërkoi të hyjë në BE, duke blerë armë nga Rusia, madje deri sisteme raketa dhe antiraketash, se avionë MiG 29, Suhoj, tanker T 74, etj., ka blerë e blen me shumicë. Sa për shkëmbimet e vizitave reciproke zyrtare, shtetërore e diplomatike, ato sa vijmë e shpeshtohen. Vuçiq, përsëri mezi



pret të shijojë corbën e nxehtë ruse, servitur nga Putini në Kremlin, pak para Sesionit Plenar të Asamblesë së Përgjithshme të OKB në Nju Jork, për të rakorduar qëndrimet, por dhënë Zoti, të mos jetë e prishur corba, e pakonsumuar prej javësh, ngaqë Carin e Kuq, autokratit "pare excellence" Vladimir Vladimiroviç Putin, gjithnjë e më rrallë do e vizitojnë homologë të tij.

Duket pak e çuditshme, por duhet pranuar, se Serbia ia ka dalë deri diku të mashtrrojë dijalet, edhe disa vende të mëdha myslimane, si Indonezia e Irani, por edhe një pjesë të vendeve arabe, që ato të mos e njohin Kosovën. Madje Serbia, është shteti evropian me raportet më të mira me Iranin e ajatollahëve, i vënë nën sanksione të forta nga bota perëndimore demokratike, për motive tashmë të njohura. Raportet e mira, që këto vende kanë me Serbinë ortodokse të masakrave në luftërat e viteve '90-të, në një pjesë të madhe ndaj popullsisë të religjionit islamik, si boshnjakët dhe shqiptarët e Kosovës, justifikohen plot hipokrizi prej tyre, nga miqësia me Titon, bashkëthemeluesin dhe Liderin e parë të vendeve të paangazhuara, nën idenë e gabuar se Serbia e sotme, nga që kryeqytet i saj ka Beogradin, është vazhdim i Jugosllavisë së dikurshme. Fakt është, se sot Kosovën e Pavarur e njohin 115 shtete, 110 prej të cilëve në vitet kur në Shqipëri qeveriste PD-ja (2005-2013) me kryeministër Berishën, e ministër të Jashtëm Bashën, diplomacia e të cilëve punoi fort me SHBA dhe vendet kryesore të BE, për vetë fuqinë, peshën dhe rolin që ato kishin dhe kanë në politikën botërore, duke i dhënë përparësi kryesore problem të mëdadh kombëtar që kemi. Në pesë vitet e qeverisjes së majtë rilindase të kryeministrit Rama, Kosovën e pavarur e njohën vetëm pesë vende, ndryshe, vetëm një shtet në vit! Një tjetër shembull i shkëlqyer i përkushtimit për çështjen kombëtare, ishte edhe ndërtimi gjatë qeverisjes së PD-së, me Berishën kryeministër dhe Bashën e Olldashin, ministra të Transportit,

i Rugrës së Kombit, kësaj kryevepre madhështore me rëndësi- jetike, historike dhe ekonomike.

Nisur nga qëllime të mira, Brukseli dhe Uashingtoni rekomanduan njsjen e negociatave për normalizimin dhe njohjen reciproke me dy shteteve, Republikës së Pavarur të Kosovës dhe Serbisë, duke ia bërë të qartë që në krye të herës serbëve, se pa pranuar Kosovën e Pavarur, sipas Rezolutës 1244 të KS së OKB, njohur ndryshe si plani Ahtisaari, duhet ta harrojnë BE-në. Por si strategjia, ashtu edhe taktikat e përfaqësuesve të delegacionit serb, gjatë gjithë këtyre viteve të negociatave pa fund, madje edhe të mërzitshme për faj të tyre, kishin dhe kanë si Ylli Polar, Yllin e Kuq të Kremlinit! Për të mos thënë asgjë, edhe në se është arritur diçka deri më tani, meritën kryesore e kanë SHBA

Ivanoviçit në Mitrovicën e Veriut më 16 janar të 2018, të cilin, idiotët e propagandës vuçiniane, pa sukses, deshën t'i ua mveshnin shqiptarëve!

Për shtimin e dukshëm të ndikimit rus në Ballkan, tashmë jo vetëm nuk duhet heshtur, por duhet ngritur zëri në kupë të qelilit dhe dhënë alarmin. Kështu u vërtetua katërcipërisht roli i Rusisë dhe agjentëve të saj në organizimin e Grushtit të Shtetit të dështuar në Mal të Zi, përzjerja përsëri e rusëve në ngjarjet e rënda në Kuvendin e Maqedonisë, ku u gjasosën deputetë, përfshi dhe kryeministër aktual Zoran Zaev, dhe shpëtoi nga vdekja pas rrahjes barbare deputeti e kryebashkiaku shqiptar i Strugës, Zijadin Sela. Nderhyrje ruse ka pasur e ka edhe në Bosnje - Hercegovinë, por më intensive e më e rrezikshme ajo është bërë pas ngritjes së një baze spionazhi rus, pranë aeroportit të Nishit, Austrostradës së Korridorit 10 dhe ngjitur me ambientet e Nafta Industrija Serbie (aksionere kryesore e Gazpromit rus), maskuar pas emrit të bukur Qendra Humanitare Ruso-Serbe!!! Qëllimi kryesor i saj është përgjimi i KFOR-it dhe bazës amerikane të Bondstill-it. BE i kërkoi Serbisë mbylljen e bazës, por ajo, jo vetëm se mbylli atë, përkundrazi, ajo po bëhet gati të lejojë edhe hapjen e një baze të dytë, kësaj here në Ecka të Vojvodinës, për të monitoruar nga afër veprimet e dy vendeve të NATO-s, Hungarisë dhe Rumanisë. Së fundi për nga radha, por jo edhe për nga rëndësia, është rritja e ndikimit rus në Shqipëri, nëpërmjet shtimit të bizneseve ruse, numrit të turistëve, blerjeve të trojeve në bregdet dhe riaktivizimit të agjenturës së tyre të vjetër apo bijve të tyre, pjesë e kraut nostalgjik filozofjik stalinist të së majtës shqiptare, i cili duket që është ende i fortë, ashtu si dhe e ka përcaktuar kohë më parë, gjeniu i kombit, Ismail Kadare!

Por ajo që ka ndodhur këto javët e fundit me Presidentin Thaçi, jo vetëm ka befusuar, por edhe ka tronditur gjithë opinionin publik të kombit. Si një rufe në qiell të hapur, ra, deklarata e parë e tij, se në negociatat me Vuçiqin, është hedhur edhe opsioni i ndarjes së Kosovës dhe se kjo me kushtin, gjoja të pranimit nga Serbia, të asaj që ka mbi dhjetë vite që është bërë fakt i kryer, Pavarësia e Kosovës. Reagimi ishte i tillë, kuptohet, ashtu si edhe duhej e ashtu si edhe pritej, ndaj dhe Thaçi "korrigoji" vetveten, teksa tha se e kanë keqkuptuar dhe se po bisedohet vetëm për korrigjim të kufijve, e jo për ndarje! As më pak e as më shumë kjo s'është gjë tjetër, veçse tradhti kombëtare, që ka lënë pa mend të madh e të vogël në trojet shqiptare e në diasporë. A ka Kushtetutë, parlament dhe qeveri shteti i Kosovës? Kush institucion ia jep të drejtën Thaçit, të bëjë pazare me serbët, për tregti me klering të trojeve shqiptare, të lara me gjakun e mijëra të vrarëve. Si u dhënka kaq lehtë Mitrovica e Isa Boletinit, Vuçiqit?! Natyrisht, kjo s'ka për të ndodhur kurrë dhe turpi e marrja do i mbulojë ata që tentuan ta bëjnë. I pari që ngriti zërin dhe doli haptas ndaj këtyre deklaratave të Thaçit, ishte doktor Berisha, por Thaçi, ky enverist i djeshëm, e "atdhetar" i thekur sot, i prekur në sedrën "patriotike", nuk vonoi t'i përgjigjej z. Berisha, me gjuhën dhe akuzat e mikut të vjetër të tij, Fatos Klosit.

Ishte po ky Hashim, që gjatë dy mandateve të doktor Berishës si kryeministër, nuk la rast pa humbur, për t'u drejtuar me superlativa atij, për vlerat dhe punën e mëdha që bëri. Hipokrizi, që na kujton Enverin me qëndrimet e njohura dyfytërshe të tij ndaj Tijos, Hrushovit dhe Maos. Fundja në rininë e tij, edhe Thaçi e kish të idhull "Qoftëlargun", paqka se ai e shiti herët Kosovën, duke mos folur pothuaj kurrë për të, gjatë më shumë se 30 viteve, ndërkohe që në famëkeqen "Zëri i Popullit", çdo ditë kishim lajme për tributë e Afrikës, indigenët e Amerikës,

maorët e Australisë, apo eskimezët e Groenlandës. Kush ia ka lënë Thaçit këto 1000 km2, që kaq "bujarisht", do t'ia linte Vuçiqit të Serbisë?! Çfarë e mban peng Thaçin, Gjykata Speciale, apo ajo e Hagës, që ne nuk do të donim ta besonim kurrë?! Në se po, le të paraqitet burrërisht e vullnetarisht si kryeministër Haradinaj, e të pastrohet nga akuzat tip Dik Marti, apo Karla Del Ponte. Po heshjen e Ramës, si duhet ta kuptojnë shqiptarët? Apo ai dhe Vuçiqi nuk dinë gjë, se Hashimi e paska bërë me kokën e vet? Burime të denja për t'u besuar, shkruajnë se kjo projekt-ide është e plakut Soros, dhe nuk duket aspak e çuditshme, apo një koicidençë që vetëm pak javë më parë, mysafir nderi i Ramës në super rezidencën luksoze verore të Enverit në Vlorë, ishte Soros Junior.

Mirëpo në "trekëndëshin ballkanik" të Bermudës që krijuan, Rama -Thaçi-Vuçiq, mund të mbyten të vetëm, pasi, askush nga të mëdhenjtë e Botës, nuk i përkrahur, madje u deklaruan rreptësisht kundër saj, siç u deklaruan opozitarët në Kosovë e Shqipëri, të gjithë fqinjët pa përjashtim, madje dhe vetë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, që u shpreh se korrigjimi i kufijve, bëhet vetëm me luftë!

Por le t'i kthehemi edhe njëherë Vuçiqit, këtij mikut të Ramës, dhe ministër ujk i dezinformimit me Slobon e Shesheljën, e sot i konvertuar në qengj presidencial i serbëve. Si duhet ta ketë informuar botën ky ministër, kur ushtarët e Armatës, policët, paramilitarët e Zhelko Raznatović Arkanit, mercenarët rusë etj., kryen tetë masakrat e mëdha në Kosovë; e Prekazit (ku u masakruan 56 Jasharajt, me legjendën Adem Jashari në krye), e Reçakut (me 45 të masakruar, kjo e denoncur botërisht nga ambasadori amerikan i OSBE, William Walker), e Izbiçës e Rezalles, e Dubravës, e Krushës së Madhe (Rahovec), e Rugovës së Hasis dhe e Studimes (Vushtrri). Dhe ja pasojat e krimeve serbe në Kosovë: 11.843 të vrarë (1.392 fëmijë dhe 1.739 femra). Dëshmorë 2.261 (68 nga Shqipëria). Ende të pagjetur 1.450. U dhunuan 20.400 femra. U shkatërruan 188.000 ndërtesa (shtëpi, shkolla, kopshte, qendra kulturore, biblioteka, xhami, kisha katolike etj.) dhe u deportuan me dhunë 792.000 (mbi 500.000 në Shqipëri, ku ne dhëmë një shembull të paprecedent; madje për Guinness, të mikpritjes vëllazërore)

Në se logarimisht edhe masakrat e krimet e tmerrshme serbe në Kroaci, e Bosnjë-Hercegovinë, si ato të Vukovarit apo Srebrenicës, na duhet të themi se me kërmbetë të kuq në Kambodhian e Pol Pot-it, Jeng Sarrt, Khieu Samphanit etj, miq të diktatorit tonë Enver Hoxha dhe serbëve të Milosheviçit, Karaxhiçit, Miladiçit, Shesheljit, Vuçiqit, Dačićit, Arkanit etj, ka pak, për të mos thënë aspak ndryshim. Tani Rama, le ta quajjë përsëri mik Vuçiqin dhe Thaçin, e lëntë shkëlqim, të le tentojë të bëjë pazare të pista e antikombëtare me të. Vuçiqi, nga ana e tij, mendon se është Stalini i 1939-1940-ës, i cili propozonte provokueshëm shkëmbim teritorresh me Finlandën, pas refuzimit të së cilës, e sulmoi brutalisht atë, por aty la kockat e 132.000 ushtarëve agresorë rusë. Presidentin serb, mund ta frymëzojmë edhe deklaratat e pak ditëve më parë të Shefit partiak të djeshëm, famëkeqit Sheshelj (të cilin Haga ia ka "ndaluar" të merret me politikë), se serbët, mund të mbërrijnë me luftë deri edhe në Durrës! Nëse, ende nuk janë mbushur me mend, pas turpërimit i shembullor nga luftëtarët shqiptarë dhe bombardimet e NATO-s, le ta provojnë përsëri, madje, vetë ata të parët, si trima të mëdhenj që qenkan, le të lidhen me zinxhirë si mburoja njëherëzore në urën e rindërtuar në Beograd, e t'ua venë gjojtun Tomahoukëve e Krizëve amerikane!

(Historian, analist, ambasador dhe diplomat i karrrierë)

Kreu i Komunës së Preshevës: Me Kosovën, por pa shkëmbim terrioresh

# Paralajmëron protesta, Kurti: Po nxjerrin Kosovën në shitje

*Dialogu me Serbinë, kreu i VV i bën thirrje opozitës*

Mbeten vetëm pak javë nga takimi i shumëpritur i presidentit Vuçiq me presidentin Thaçi ndërkohë që nuk janë mbyllur ende as diskutimet lidhur me kufirin Kosovë-Serbi. Albin Kurti, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, duke komentuar korrigjimin e kufirit, u ka bërë thirrje anëtarëve të saj që të mobilizohen pasi në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosen në krye të protestave qytetare dhe paqësore për siç ka thënë "ta ndalur krimin që po i bëhet Kosovës dhe popullit tonë". Kurti në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të VV-së, ka thënë se fatkeqësisht Kosova po kalon në një moment të vështirë. "Një udhëheqësi e kapur dhe e kriminalizuar, e udhëhequr nga Thaçi, po e nxjerr në shitje territorin e Kosovës për të fituar paprekshmërinë individuale. Ne këtë nuk duhet dhe nuk do ta lejojmë pasi e kemi obligim historik dhe moral. Situata politike është ajo që ka nevojë për forcim të organizatës në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosemi në krye të protestave qytetare dhe paqësore për ta ndalur këtë krim që po bëhet ndaj Kosovës dhe popullit tonë", ka thënë Kurti. Ndërkaq për sa i përket idesë për të shkëmbyer territore mes Kosovës e Serbisë, një gjë të tillë se mbështesin drejtuesit e komunës së Preshevës, kryetari i së cilës, Shqiprim Arifi i përkrah më së shumti planet që kjo zonë të bashkohet me Kosovën, por jo një skenar, i cili do të përfshinte që në këmbim, Serbisë t'i japin pjesë të tjera të vendit. Arifi e artikulon qartë mendimin e tij: një Kosovë në kufijtë aktual e pranuar prej mbi 100 shteteve të botës, është në interesin e Preshevës. Në qoftë se bazohemi në referendumin e vitit 1992, kërkesën e shqiptarëve të luginës për të pasur një autonomi territoriale politike, me të drejtë



Kreu i Vetë Vendosjes Albin Kurti

**SHQIPRIM ARIFI:**

"Një Kosovë në kufijtë aktual, e pranuar prej mbi 100 shteteve të botës, është në interesin e Preshevës. Në qoftë se bazohemi në referendumin e vitit 1992, dhe në qoftë se ndërkombehtarët e mbështesin një gjë të tillë, pa shkëmbim terrioresh dhe pa efekte anësore, atëherë ne jemi dakord", -ka thënë Arifi.

bashkimi me Republikën e Kosovës, dhe në qoftë se ndërkombehtarët e mbështesin një gjë të tillë, pa shkëmbim terrioresh dhe pa efekte anësore, atëherë ne jemi dakord, ishte mesazhi i tij. Por vetëm kaq. Shqiptarët e Preshevës e kanë treguar se i ngrohin ide bashkimi, por në fund, janë të interesuar më së pari për stabilitet. Çdo shkëmbim terrioresh, sipas Arifit, do të kishte efekte anësore dhe banorët atje do ta pësonin më shumë të tjerët.

Këtu Arifi citon të kaluarën duke kujtuar, se për ata, nuk është kujdesur askush. Në këtë drejtim, sgaron ai, një Kosovë me integritetin e saj territorial, ashtu siç është pranuar deri tani është në interesin tonë. Është në interesin tonë që të pranohet edhe në OKB kështu siç është, sepse dhe për ne, vazhdon ai, një Kosovë e tillë në të ardhmen, do të jetë më e fuqishme. Ndërkaq që para dy ditësh presidenti Thaçi tha se është koha për mar-

**ALBIN KURTI:**

"Një udhëheqësi e kapur dhe e kriminalizuar, e udhëhequr nga Thaçi, po e nxjerr në shitje territorin e Kosovës për të fituar paprekshmërinë individuale. Situata politike është ajo që ka nevojë për forcim të organizatës në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosemi në krye të protestave qytetare dhe paqësore për ta ndalur këtë krim që po bëhet ndaj Kosovës dhe popullit tonë", -ka thënë Kurti.

rëvshjen e madhe historike mes Kosovës dhe Serbisë. "Nuk mund të kthehemi prapa, sepse historia e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një histori tragjike. Nuk mund të qëndrojmë në vend apo të vendnumërojmë dhe as nuk kemi se çfarë të presim, sepse gjecja dhe pritja në zgjidhjen e raporteve në mes Kosovës dhe Serbisë është pikërisht thirrje për tensione, për destabilizim, për probleme të mëdha, jo vetëm në mes nesh, por edhe në mbarë rajonin", ka thënë Thaçi.

## Brexit, May zotohet se nuk do të bëjë kompromis me BE-në

### Referendum të dytë? Kryeministrja britanike: Tradhti e besimit të popullit

Ditën e djeshme kryeministrja britanike, Theresa May, ka këmbëngulur se ajo nuk do të detyrohet të bëjë kompromis mbi planin e saj të Brexit gjatë negociatave me BE. Duke folur për 'Sunday Telegraph', kryeministrja thotë se ajo "nuk do të jetë e nxitur" për kompromise, të cilat nuk janë në favor të "interetit kombëtar". May' gjithashtu paralajmëron se ajo nuk do t'u dorëzohet thirrjeve për një referendum të dytë mbi marrëveshjen e tërheqjes nga BE. Ajo thotë se do të ishte një "tradhti e madhe e demokracisë dhe besimit të popullit", shkruan BBC. Marrëveshja Chequers do të bënte të mundur që



Mbretëria e Bashkuar të pranonte një "rregullore të përgjithshme" me BE-në për tregtimin e mallrave, në mënyrë që të zhvillohet një tregti pa probleme në kufi. Por kritikët thonë se kjo

**THERESA MAY:**

"Nuk do të nxitim për kompromise, të cilat nuk janë në favor të interesit kombëtar. Gjithashtu, nuk do t'u dorëzohem thirrjeve për një referendum të dytë mbi marrëveshjen e tërheqjes nga BE. Do të ishte një tradhti e madhe e demokracisë dhe besimit të popullit nëse do ta pranoja", -ka thënë May për mediat.

marrëveshje do ta lerë Mbretërinë e Bashkuar të lidhur me rregullat e BE-së dhe do ta pengojë Britaninë që të vendosë rregullat e saj në marrëveshjet e tregtisë për vitet që vijnë. Votimi i Popullit, një grup ndërpartiak duke përfshirë disa deputetë, po bën thirrje për një votim publik mbi marrëveshjen përfundimtare të Brexit. Mbretëria e Bashkuar do të largohet nga BE më 29 mars 2019, por ende nuk kanë rënë dakord se si do të funksionojë lidhja e saj përfundimtare me bllokun. BE ka sugjeruar se nëntori është afati i fundit për të arritur një përfundim të një marrëveshjeje.

## HOROSKOPI

**DASHI**

Sot dita juaj do të nisë me shumë energji dhe forcë. Pothuajse gjithçka që keni në plan do të funksionojë siç duhet. Asgjë nuk mund t'ju pengojë të arrini sukses.

**DEMI**

Sot pritet të jetë një prej atyre ditëve ku do të ndiheni i lumturuar me pak gjëra. Yjet do ju ndihmojnë në shumë aspekte, por me vëmendje të veçantë në profesion.

**BINJAKET**

Do të jetë një ditë e shkëlqyer për të përfunduar planet tuaja. Vendosja e yjeve do t'ju bëjnë që të keni shumë energji. Nëse fokusoheni në prioritetet, asgjë nuk do t'ju ndalë.

**GAFORJA**

Sot do të jetë dita e duhur për të rinisur disa projekte, të cilat i kishit lënë në mes prej kohësh. Jini produktiv duke vendosur të gjithë energjinë tuaj në funksion të suksesit.

**LUANI**

Është dita e duhur për t'u angazhuar në projekte, detyra të rëndësishme etj. Bëjini rezistencë tundimit për t'i lënë punët për nesër. Nëse nuk veproni menjëherë do të humbisni mbështetjen kozmike.

**VIrgjeresha**

Mund të keni sukses në detyrat që ju janë ngarkuar për të bërë. Kjo për shkak të energjisë pozitive nga e cila do të rrethoheni, veçanërisht gjatë pjesës së dytë të ditës.

**PESHORJA**

Mos lejoji që mundësitë t'ju shpëtojnë nga duart. Kapani rastin dhe do të ndiheni i kënaqur me rezultatin. Sot është momenti i duhur për t'u marrë me sportin tuaj të preferuar.

**AKREPI**

Do të ndiheni shumë nervoz sot dhe pa energji. Tensioni mund të vijë nga të katër anët. Problemi më i madh që keni është se jeni i pavendosur. Mos bëni lëvizje pa i vlerësuar mirë pasojat.

**SHIGJETARI**

Shijoni ditën. Jeni në gjendje shumë të mirë fizike dhe shpirtërore. Nëse mundësitë tuaja vijnë në dorë, mos lejoji që t'ju shpëtojnë. Parashikohet një ditë me shume aktivitet.

**BRICJAPI**

Çështjet e romancës do të shkojnë si asnjëherë më mirë gjatë ditës se sotme. Do të gjeni atë çfarë keni dëshiruar gjithmonë të partneri juaj. Do të përfshihen nga pasiguritë.

**UJORI**


Nga plani i dashurisë, gjërat do të shkojnë mirë për ju sot. Lëreni anën tuaj romantike të shkëlqejë plotësisht. Kaloni një darkë të paharruar në një restorant të mirë.

**PESHQIT**

Çlironi nga kontrolli i tepërt. Ju e dini mirë çfarë kërkon, thjesht besojni intuitës. Në dashuri jo çdo ecën sipas planit, por kjo mund të bëjë që keni shumë sur-



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshhtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshhtë anije me dy skafë.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendari.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

**VERTIKAL**

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshhtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Eshhtë shpend lagune.
- Eshhtë operator që bën zoom.
- Eshhtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshhtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përsëhëdetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimin.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishte shkolla e Aristotelit
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.

**VERTIKAL**


- Ekstremet e tokës.
- Inicialet e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrjej Marco Pantani.
- Pak ireducentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vullkanesh
- Eshhtë edhe ai Persik.
- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Eshhtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Aje ku shkollon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshhtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshhtë Ilon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



**SUDOKU**

			3			4	8		
	1	5		2	9				
		1							
	5		4	7			6		
						8		2	
3	9			6	7	5			
	7				3	6	2		
5	6								4

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	5	8	9	7	6	1	3	2	
2	3	7	5	8	1	4	6	9	
6	1	9	2	3	4	5	7	8	
5	6	3	4	9	8	7	2	1	
7	8	4	1	2	5	3	9	6	
9	2	1	7	6	3	8	4	5	
8	4	2	6	1	7	9	5	3	
1	7	6	3	5	9	2	8	4	
3	9	5	8	4	2	6	1	7	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Një burrë nuk është i plotë derisa të mbarohet. Pastaj është i mbaruar.
- Nëse rrudhat duhet të "shkruhen" mbi ballin tonë, nuk duhet të "shkruhen" dhe në zemër. Shpirti nuk duhet të plakët.
- Në qoftë se është art, nuk është për të gjithë, nëse është për të gjithë, nuk është art.
- Nuk ka rëndësi nëse macja është e zezë ose të bardhë, mjafton të kapi minj.
- Kur vret një njeri je vrasës, kur vret miliona je pushtues, kur i vret të gjithë, je zot.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	P	11	16	7	5	15	8		3	8	A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T		
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12	D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2	R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2			F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
	5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16		F		E	K	O	N	O	M	I	A	D
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7		R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15		A	N	T	E	N	A	T	A	A	B	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7		N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6		K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8		I	B	A	N	A	K	A	E	T		
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7			B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5			E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

*Thënie të mënçura*

- Miqësia ndërpritet aty ku futet borxhi.
- Dinakëria më e bukur e djallit, është të na bindë se nuk ekziston.
- Liria e një personi duhet të arrijë deri aty sa që mos të shkelë lirinë e të tjerëve.
- Kur mendon se ndoshta nuk mundesh, keni të drejtë. Nuk mundesh.

